

KONVENTA

# KONVENTA

për

Mbrojtjen dhe Zhvillimin e

Larmisë së  
Shprehjeve  
Kulturore



United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization

MDG:IF  
MDG ACHIEVEMENT FUND



United Nations  
ALBANIA



CLT/CEI/DCE/2007/PI/32

# KONVENTA

për  
Mbrotjen dhe Zhvillimin e

## Larmisë së Shprehjeve Kulturore

Paris, 20 tetor 2005<sup>1</sup>

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, mbledhur në Paris nga data 3 deri në 21 tetor 2005 në sesionin e saj të 33-të:

*Duke pohuar* që larmia kulturore është një karakteristikë përcaktuese e njerëzimit;

*E ndërgjegjshme* që larmia kulturore krijon një trashëgimi të përbashkët të njerëzimit dhe që duhet të zhvillohet dhe ruhet për të mirën e të gjithëve;

*Me vetëdije* që larmia kulturore krijon një botë të pasur dhe të larmishme, e cila rrit gamën e zgjedhjeve dhe ushqen kapacitetet dhe vlerat e njeriut dhe për rrjedhojë është një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm për komunitetet, popujt dhe kombet;

*Duke kujtuar* që larmia kulturore, e cila zhvillohet brenda kuadrit të demokracisë, tolerancës, drejtësisë sociale dhe respektit reciprok ndërmjet njerëzve dhe kulturave është e domosdoshme për paqen dhe sigurinë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;

*Duke përkujtuar* rëndësinë e larmisë kulturore për realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe në instrumente të tjera të njohura në gjithë botën;

*Duke theksuar* nevojën për të përfshirë kulturën si një element strategjik në politikat e zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në bashkëpunimin për zhvillimin ndërkombëtar, duke pasur parasysh gjithashtu Deklaratën e Mijëvjeçarit (2000) të Kombeve të Bashkuara që i vë theks të veçantë zhdukjes së varfërisë;

*Duke pasur parasysh* që kultura merr trajta të ndryshme në kohë dhe hapësirë dhe që kjo larmi është mishëruar në veçantinë dhe shumësinë e identiteteve dhe shprehjeve kulturore të popujve dhe shoqërive që krijojnë njerëzimin;

*Duke pranuar rëndësinë* e njohurive tradicionale si një burim i pasurisë së paprekshme dhe materiale dhe në veçanti sistemet e njohurive të popujve indigjenë dhe kontributin e tyre pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe nevojën për mbrotjen dhe zhvillimin e duhur të tyre;

<sup>1</sup> Shqipëria u bë palë e kësaj Konvente më 17.11.2006.

*Duke pranuar nevojën për marrjen e masave për të mbrojtur larminë e shprehjeve kulturore, përfshirë këtu përmbajtjen e tyre, veçanërisht në situata ku shprehjet kulturore mund të kërcënohen nga mundësia e zhdukjes apo e dëmtimit serioz;*

*Duke theksuar rëndësinë e kulturës për kohezion social në përgjithësi dhe veçanërisht potencialin e saj për rritjen e statusit dhe rolit të gruas në shoqëri;*

*E vetëdijshme që larmia kulturore forcohet me anë të fluksit të lirë të ideve dhe që rritet me anë të shkëmbimit dhe ndërveprimit të vazhdueshëm ndërmjet kulturave;*

*Duke pohuar sërish që liria e mendimit, shprehjes dhe informacionit, si dhe larmia e medias, bëjnë të mundur që shprehjet kulturore të zhvillohen brenda shoqërive;*

*Duke pranuar që larmia e shprehjeve kulturore, përfshirë këtu shprehjet kulturore tradicionale është një faktor i rëndësishëm që lejon individët dhe popujt të shprehin dhe të ndajnë me të tjerët idetë dhe vlerat e tyre;*

*Duke kujtuar që larmia gjuhësore është një element thelbësor i larmisë kulturore dhe duke pohuar sërish rolin thelbësor që luan edukimi në mbrojtjen dhe zhvillimin e shprehjeve kulturore;*

*Duke pasur parasysh rëndësinë e forcës së kulturës, përfshirë këtu personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë, të manifestuar në lirinë e tyre për të krijuar, përhapur dhe ndarë shprehjet tradicionale kulturore dhe për të pasur mundësinë e përdorimit të tyre, me qëllim që t'i përfitojnë ato për zhvillimin e tyre;*

*Duke theksuar rolin e rëndësishëm të ndërveprimit dhe krijueshmërisë kulturore që rrisin dhe ripërtërijnë shprehjet kulturore dhe rrisin rolin që luajnë të interesuarit e përfshirë në zhvillimin e kulturës për ecurinë e gjithë shoqërisë;*

*Duke pranuar rëndësinë e të drejtave të pronësisë intelektuale në mbështetje të të interesuarve të përfshirë në krijueshmërinë kulturore;*

*E bindur që veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore janë të një natyre ekonomike dhe kulturore, sepse përcjellin identitete, vlera dhe kuptime dhe për këtë nuk duhet të trajtohen vetëm për vlerën tregtare;*

*Duke vënë në dukje që ndërsa proceset e globalizimit të cilat janë lehtësuar nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përballojnë kushtet pa precedent për ndërveprim të rritur ndërmjet kulturave, ato paraqesin gjithashtu një sfidë për larminë kulturore, kryesisht duke pasur parasysh rreziqet e çekuilibrit ndërmjet vendeve të varfra dhe të pasura;*

*E vetëdijshme për mandatin e veçantë të UNESCO-s për të siguruar respektimin e larmisë së kulturave dhe për të rekomanduar këto marrëveshje ndërkombëtare që mund të jenë të nevojshme për nxitjen e fluksit të lirë të ideve me anë të fjalës dhe imazhit;*

*Duke i'u referuar dispozitave të instrumenteve ndërkombëtare të miratuara nga UNESCO në lidhje me larminë kulturore dhe ushtrimin e të drejtave kulturore dhe në veçanti Deklaratës Universale për Larminë Kulturore të vitit 2001;*

Miraton këtë Konventë më 20 tetor 2005

## I. Objektivat dhe parimet drejtuese

### **Neni 1 - OBJEKTIVAT**

Objektivat e kësaj Konvente janë:

- a) të mbrojnë dhe të zhvillojnë larminë e shprehjeve kulturore;
- b) të krijojnë kushtet që kulturat të zhvillohen dhe të ndërveprojnë lirshëm në një mënyrë huazi të dobishme;
- c) të inkurajojnë dialogun ndërmjet kulturave me synim që të sigurojë një shkëmbim më të madh dhe të balancuar kulturor në botë në favor të respektit ndërkulturor dhe një kulture të paqes;
- d) të nxisë ndërthurjen kulturore për të zhvilluar ndërveprimin kulturor me frymën e ndërtimit të urave ndërmjet popujve;
- e) të nxisë respektin për larminë e shprehjeve kulturore dhe të ndërgjegjësojë vlerat e saj në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- f) të pohojë sërish rëndësinë e lidhjes ndërmjet kulturës dhe zhvillimit për të gjitha vendet, veçanërisht për vendet në zhvillim dhe të përkrahë masat e ndërmarra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të siguruar njohjen e vlerës së vërtetë të kësaj lidhjeje;
- g) të bëjë të kuptueshme natyrën e veçantë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore, si mjete të identitetit, vlerave dhe kuptimit;
- h) të pohojë sërish të drejtat sovrane të shteteve për të ruajtur, miratuar dhe zbatuar politikën dhe masat që ato i gjykojnë të duhura për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore në territorin e tyre;
- i) të forcojë bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërkombëtar me frymën e partneritetit me synim, në veçanti, rritjen e kapaciteteve të vendeve në zhvillim për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore.

### **Neni 2 - PARIMET DREJTUESE**

#### **1. Parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut**

Larmia kulturore mund të mbrohet dhe të zhvillohet vetëm nëse garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si liria e shprehjes, informacionit dhe komunikimit, si dhe aftësia e individëve për të zgjedhur shprehjet kulturore. Askush nuk mund të përdorë dispozitat e kësaj Konvente për të shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të garantuara në të drejtën ndërkombëtare ose të kufizojë fushën e veprimit.

#### **2. Parimi i sovranitetit**

Shtetet në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, kanë të drejtën sovranë të miratojnë masa dhe politika për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të tyre.

#### **3. Parimi i dinjitetit të barabartë dhe i respektimit të të gjitha kulturave**

Mbrojtja dhe zhvillimi i larmisë së shprehjeve kulturore prezumon njohjen e dinjitetit të barabartë dhe respektimin e të gjitha kulturave, përfshirë këtu kulturat e personave që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë.

#### **4. Parimi i solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar**

Bashkëpunimi dhe solidariteti ndërkombëtar duhet të synojnë që të bëjnë të mundur që vendet, veçanërisht vendet në zhvillim, të krijojnë dhe të forcojnë mënyrat e tyre të shprehjes kulturore, përfshirë këtu industrinë e tyre kulturore, në lindje e sipër apo të krijuara, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### **5. Parimi i komplementaritetit të aspekteve ekonomike dhe kulturore të zhvillimit**

Meqë kultura është një nga forcat lëvizëse të zhvillimit, aspektet kulturore të zhvillimit janë po aq të rëndësishme sa aspektet ekonomike në të cilat individët dhe popujt kanë të drejtën themelore të marrin pjesë dhe t'i gëzojnë ato.

#### **6. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm**

Larmia kulturore është një aset i pasur për individët dhe shoqëritë. Mbrojtja, zhvillimi dhe ruajtja e larmisë kulturore janë një kërkesë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm në të mirë të brezave të së tashmes dhe të së ardhmes.

## 7. Parimi i përdorimit të arsyeshëm

E drejta e përdorimit të arsyeshëm të një game të pasur dhe të larmishme të shprehjeve kulturore nga e gjithë bota dhe e drejta e kulturave për të përdorur mjetet e shprehjes dhe shpërndarjes përbëjnë elementë të rëndësishëm për rritjen e larmisë kulturore dhe inkurajimin e kuptimit reciprok.

## 8. Parimi i hapjes dhe i ekuilibrit

Kur shtetet miratojnë masa për të përkrahur larminë e shprehjeve kulturore, ato duhet të zhvillojnë, në mënyrën e duhur, hapjen ndaj kulturave të tjera të botës dhe të sigurojnë që këto masa të hartohen për objektivat e ndjekura sipas Konventës në fjalë.

## II. Fusha e zbatimit

### Neni 3 - FUSHA E ZBATIMIT

Kjo Konventë zbatohet për politikat dhe masat e miratuara nga palët në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmive të shprehjeve kulturore.

## III. Përkufizime

### Neni 4 - PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj Konvente, kuptohet që:

#### 1. Larmi kulturore

“Larmia kulturore” ka të bëjë me mënyrat e ndryshme ku gjejnë shprehje kulturat dhe shoqëritë. Këto shprehje kalojnë midis dhe ndërmjet grupeve dhe shoqërive.

Larmia kulturore është shfaqur jo vetëm përmes mënyrave të ndryshme me anë të të cilave shprehet trashëgimia kulturore e njerëzimit, e rritur dhe e transmetuar përmes larmisë së shprehjeve kulturore, por edhe përmes mënyrave të ndryshme të krijimit artistik, prodhimit, shpërndarjes, ndarjes dhe gëzimit të tyre, çfarëdo qofshin mjetet dhe teknologjitë e përdorura.

#### 2. Përmbajtje kulturore

“Përmbajtja kulturore” ka të bëjë me kuptimin simbolik, dimensionin artistik dhe vlerat kulturore që e kanë origjinën nga, ose që shprehin identitete kulturore.

#### 3. Shprehje kulturore

“Shprehje kulturore” janë shprehjet që rezultojnë nga krijueshmëria e individëve, grupeve dhe shoqërive dhe që kanë përmbajtje kulturore.

#### 4. Veprimtari, të mira dhe shërbime kulturore

“Veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore” janë veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet që në kohën kur janë konsideruar si një atribut, përdorim apo qëllim specifik, mishërojnë ose përcjellin shprehje kulturore, pavarësisht nga vlera tregtare që mund të kenë.

Veprimtari kulturore mund të jenë qëllim në vetvete ose mund të kontribuojnë në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve kulturore.

#### 5. Industritë kulturore

“Industritë kulturore” janë industritë që prodhojnë dhe shpërndajnë mallra ose shërbime kulturore të përkufizuara në paragrafin 4.

#### 6. Politikat dhe masat kulturore

“Politikat dhe masat kulturore” janë ato politika dhe masa që lidhen me kulturën, në nivel lokal, kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar të cilat ose janë përqendruar në kulturën si të tillë, ose janë hartuar për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në shprehjet kulturore të individëve, grupeve ose shoqërive, duke përfshirë krijimin, prodhimin, ndarjen, shpërndarjen dhe të drejtën e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore.

## 7. Mbrojtja

"Mbrojtja" ka të bëjë me miratimin e masave që synojnë ruajtjen, sigurimin dhe shtimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

"Të mbrosh" do të thotë miratoj këto masa.

## 8. Ndërthurja kulturore

"Ndërthurja kulturore" ka të bëjë me ekzistencën dhe ndërveprimin e drejtë të kulturave të ndryshme dhe mundësinë e prodhimit të shprehjeve të përbashkëta kulturore me anë të dialogut dhe respektit të ndërsjellë.

## IV. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

### **Neni 5 - RREGULLI I PËRGJITHSHËM NË LIDHJE ME TË DREJTAT DHE DETYRIMET**

1. Palët, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe instrumente për të drejtat e njeriut të njohura në botë, pohojnë sërish të drejtën e tyre sovranë për të formuluar dhe zbatuar politikat e tyre kulturore dhe për të miratuar masat për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente.

2. Kur një palë zbaton politika dhe merr masa për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të saj, politikat dhe masat e saj do të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

### **Neni 6 - TË DREJTAT E PALËVE NË NIVEL KOMBËTAR**

1. Secila palë, brenda kuadrit të politikave dhe masave të saj kulturore si përkufizohen në nenin 4.6 dhe duke pasur parasysh rrethanat dhe nevojat e saj të veçanta, mund të miratojë masat që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore brenda territorit të saj.

2. Këto masa mund të përfshijnë sa më poshtë:

- a) masat rregullatore që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;
- b) masat që, në mënyrën e duhur, sigurojnë mundësi për veprimtari, të mira dhe shërbime kulturore në vend midis të gjitha atyre që janë në dispozicion brenda territorit kombëtar për krijimin, prodhimin, ndarjen, shpërndarjen dhe gëzimin e këtyre veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore në vend;
- c) masat që synojnë të sigurojnë për industritë kulturore të pavarura në vend dhe veprimtaritë në sektorin jo formal të drejtës e përdorimit efektiv të mjeteve të prodhimit, shpërndarjes dhe ndarjes së veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore;
- d) masa që synojnë të sigurojnë ndihmës publike financiare;
- e) masat që synojnë të inkurajojnë organizatat jo fitimprurëse, si dhe institucionet publike dhe private dhe artistët dhe profesionistët e tjerë kulturorë, të zhvillojnë dhe të nxisin shkëmbimin dhe qarkullimin e lirë të ideve, shprehjeve kulturore dhe veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore dhe të nxisin frymën krijuese dhe sipërmarrëse në veprimtaritë e tyre;
- f) masat që synojnë të krijojnë dhe përkrahin institucionet publike, në formën e duhur;
- g) masat që synojnë të nxisin dhe të përkrahin artistët dhe të tjerë të përfshirë në krijimin e shprehjeve kulturore;
- h) masat që synojnë të rrisin larminë e medias, duke përfshirë transmetimin e shërbimit publik.

### **Neni 7 - MASAT PËR TË ZHVILLUAR SHPREHJET KULTURORE**

1. Palët do të përpiqen të krijojnë në territorin e tyre një mjedis që inkurajon individët dhe grupet shoqërore:

- a) të krijojnë, prodhojnë, ndajnë, shpërndajnë dhe përdorin shprehjet e tyre kulturore, duke i kushtuar

vëmendjen e duhur rrethanave dhe nevojave të veçanta të grave, si dhe grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë;

b) të përdorin shprehje të ndryshme kulturore nga territori i tyre, si dhe nga vende të tjera të botës.

2. Palët do të përpiqen të njohin kontributin e rëndësishëm të artistëve, të tjerëve të përfshirë në procesin krijues, komuniteteve kulturore dhe organizatave që mbështesin punën e tyre dhe rolin e tyre thelbësor në rritjen e larmisë së shprehjeve kulturore.

### **Neni 8 - MASAT PËR TË MBROJTUR SHPREHJET KULTURORE**

1. Pa paragjykuar dispozitat e neneve 5 dhe 6, një Palë mund të përcaktojë ekzistencën e situatave të veçanta ku shprehjet kulturore në territorin e saj janë në rrezik për zhdukje, në kërcënim të rëndë ose në të kundërt në nevojë për mbrojtje urgjente.

2. Palët mund të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dhe ruajtur shprehjet kulturore në situatat e përmendura në paragrafin 1 në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Palët i raportojnë Komitetit Ndërqeveritar të përmendur në nenin 23 për të gjitha masat e marra për të përballuar nevojën urgjente të situatës dhe Komiteti mund të bëjë rekomandimet e duhura.

### **Neni 9 - NDARJA E INFORMACIONIT DHE TRANSPARENCA**

Palët:

- a) sigurojnë informacionin e duhur në raportet e tyre për UNESCO-n çdo katër vjet mbi masat e marra për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore brenda territorit të tyre dhe në nivel ndërkombëtar;
- b) caktojnë një pikë kontakti përgjegjës për ndarjen e informacionit në lidhje me këtë Konventë;
- c) ndajnë dhe shkëmbejnë informacion në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

### **Neni 10 - EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT**

Palët:

- a) inkurajojnë dhe nxisin kuptimin e rëndësisë së mbrojtjes dhe zhvillimit të larmisë së shprehjeve kulturore, inter alia, me anë të programeve edukative dhe programeve që ndërgjegjësojnë publikun më tepër;
- b) bashkëpunojnë me palët e tjera dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale për të arritur qëllimin e këtij neni;
- c) përpiqen të inkurajojnë krijueshmërinë dhe të forcojnë kapacitetet e prodhimit duke krijuar programe edukative, trajnimi dhe shkëmbimi në fushën e industrive kulturore. Këto masa duhet të zbatohen në një mënyrë që nuk ndikon negativisht në format tradicionale të prodhimit.

### **Neni 11 - PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE**

Palët e njohin rolin themelor të shoqërisë civile në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore. Palët inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për të arritur objektivat e kësaj Konvente.

### **Neni 12 - NXITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR**

Palët përpiqen të forcojnë bashkëpunimin e tyre dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar për krijimin e kushteve që nxisin zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, duke marrë parasysh në veçanti situatat e përmendura në nenet 8 dhe 17, sidomos me qëllim që:

- a) të lehtësohet dialogu për politikën kulturore ndërmjet Palëve;
- b) të rriten kapacitetet e menaxhimit dhe ato strategjike të sektorit publik në institucionet kulturore të sektorit publik me anë të shkëmbimeve kulturore profesionale dhe ndërkombëtare dhe ndarjes së praktikave më të mira;
- c) të forcohen partneritetet me dhe ndërmjet shoqërisë civile, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për nxitjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;



- d) të nxitet përdorimi i teknologjive të reja, të inkurajohen partneritetet për të shtuar ndarjen e informacionit dhe mirëkuptimin kulturor dhe të nxitet larmia e shprehjeve kulturore;
- e) të inkurajohet përfundimi i marrëveshjeve për bashkëprodhim dhe bashkëshpërndarje.

### **Neni 13 - INTEGRIMI I KULTURËS NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM**

Palët përpiqen të përfshijnë kulturën në politikat e tyre të zhvillimit në të gjitha nivelet për krijimin e kushteve që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe, brenda këtij kuadri, të nxisin aspektet në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore.

### **Neni 14 - BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM**

Palët përpiqen të përkrahin bashkëpunimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë, veçanërisht në lidhje me nevojat specifike të vendeve në zhvillim, me synim nxitjen e shfaqjes së një sektori dinamik kulturor, *inter alia*, me anë të mënyrave të mëposhtme:

- a) duke forcuar industrinë kulturore në vendet në zhvillim me anë të:
  - i) krijimit dhe forcimit të prodhimit kulturor dhe kapaciteteve të shpërndarjes në vendet në zhvillim;
  - ii) lehtësimit të përdorimit më të gjerë në tregun botëror dhe në rrjetet ndërkombëtare të shpërndarjes për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet e tyre kulturore;
  - iii) mundësimin të shfaqjes së tregjeve të suksesshme lokale dhe rajonale;
  - iv) miratimit, kur është e mundur, të masave të duhura në vendet e zhvilluara me synim lehtësimin e përdorimit në territorin e tyre të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore të vendeve në zhvillim;
  - v) sigurimit të përkrahjes për punë krijuese dhe lehtësimin të lëvizjes, sa më shumë të jetë e mundur, e artistëve nga bota në zhvillim;
  - vi) inkurajimit të duhur të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim në fushat, *inter alia*, e muzikës dhe filmit;
- b) duke forcuar kapacitetet me anë të shkëmbimit të informacionit, përvojës dhe ekspertizës, si dhe duke trajnuar burimet njerëzore në vendet në zhvillim, në sektorin privat dhe publik në lidhje me *inter alia*, kapacitetet strategjike dhe të menaxhimit, zhvillimin dhe zbatimin e politikave, zhvillimin dhe shpërndarjen e shprehjeve kulturore, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përdorimin e teknologjisë dhe zhvillimin dhe transferimin e aftësive;
- c) duke transferuar teknologjinë me anë të prezantimit të masave të duhura nxitëse për transferimin e teknologjisë dhe njohurive, veçanërisht në fushën e industrive dhe ndërmarrjeve kulturore;
- d) duke siguruar ndihmë financiare me anë të:
  - i) krijimit të një fondi ndërkombëtar për larminë kulturore si parashikohet në nenin 18;
  - ii) sigurimit të ndihmës për zhvillimin, sipas rastit, përfshirë këtu ndihmën teknike, për të nxitur dhe përkrahur krijeshmërinë;
  - iii) formave të tjera të ndihmës financiare si interesa të ulëta huaje, grante dhe mekanizma të tjerë financimi.

### **Neni 15 - RREGULLIME BASHKËPUNUESE**

Palët inkurajojnë zhvillimin e partneriteteve ndërmjet dhe brenda sektorëve publikë dhe privatë dhe organizatave jo fitimprurëse për të bashkëpunuar me vendet në zhvillim në lidhje me rritjen e kapaciteteve të tyre për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore. Këto partneritete të reja sipas nevojave praktike të vendeve në zhvillim theksojnë zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe politikave, si dhe shkëmbimin e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore.

### **Neni 16 - TRAJTIMI PREFERENCIAL PËR VENDET NË ZHVILLIM**

Vendet e zhvilluara lehtësojnë shkëmbimet kulturore me vendet në zhvillim duke u dhënë artistëve, profesionistëve dhe ekspertëve të tjerë kulturorë, me anë të strukturave të duhura institucionale dhe ligjore, trajtim preferencial, si dhe të mira dhe shërbime kulturore nga vendet në zhvillim.

### **Neni 17 - BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË SITUATA QË JANË KËRCËNIM I RËNDË PËR SHPREHJET KULTURORE**

Palët bashkëpunojnë për të siguruar ndihmë për njëra-tjetrën dhe në veçanti për vendet në zhvillim, në situatat e përmendura në nenin 8.

### **Neni 18 - FONDI NDËRKOMBËTAR PËR LARMINË KULTURORE**

1. Një Fond Ndërkombëtar për Larminë Kulturore, tani e tutje i përmendur si "Fondi" krijohet në këtë mënyrë.
2. Fondi përbëhet nga fonde në mirëbesim të krijuara në përputhje me rregulloret financiare të UNESCO-s.
3. Burimet e Fondit përbëhen nga:
  - a) kontribute vullnetare të bëra nga palët;
  - b) fonde të caktuara për këtë qëllim nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s;
  - c) kontribute, dhurata apo trashëgimi nga shtete të tjera; organizata dhe programe të sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizata të tjera rajonale ose ndërkombëtare; organe apo individë publikë ose privatë;
  - d) çdo interes për burimet e Fondit;
  - e) fondet e mbledhura me anë të mbledhjeve dhe arkëttimeve nga ngjarjet e organizuara për përfitim të Fondit;
  - f) burime të tjera të autorizuara nga rregulloret e fondit.
4. Përdorimi i burimeve të Fondit vendoset nga Komiteti Ndërqeveritar në bazë të udhëzimeve të caktuara nga Konferenca e Palëve e përmendur në nenin 22.
5. Komiteti Ndërqeveritar mund të pranojë kontribute dhe forma të tjera të ndihmës për qëllime të përgjithshme dhe specifike në lidhje me projekte specifike, me kusht që këto projekte të jenë të miratuara prej tij.
6. Asnjë kusht politik, ekonomik apo tjetër që nuk është në pajtim me objektivat e kësaj Konvente nuk mund t'i bashkëngjitet kontributeve që janë bërë për Fondin.
7. Palët përpiqen të sigurojnë rregullisht kontribute vullnetare për zbatimin e kësaj Konvente.

### **Neni 19 - SHKËMBIMI, ANALIZIMI DHE PËRHAPJA E INFORMACIONIT**

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacion dhe të ndajnë ekspertizën në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave për larminë e shprehjeve kulturore, si dhe për praktikatat më të mira për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj.
2. UNESCO lehtëson, me anë të përdorimit të mekanizmave ekzistues brenda Sekretariatit, mbledhjen, analizimin dhe përhapjen e të gjithë informacionit përkatës, statistikave dhe praktikave më të mira.
3. UNESCO krijon gjithashtu dhe përditëson një bankë të dhënash për sektorë të ndryshëm dhe organizata qeveritare, private dhe jofitimprurëse të përfshirë në fushën e shprehjeve kulturore.
4. UNESCO, për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave, i kushton vëmendje të veçantë rritjes së kapaciteteve dhe forcimit të ekspertizës për palët që paraqesin një kërkesë për këtë ndihmë.
5. Mbledhja e informacionit të identifikuar në këtë nen plotëson informacionin e mbledhur sipas dispozitave të nenit 9.

## **V. Marrëdhënia me instrumente të tjera**

### **Neni 20 - MARRËDHËNIA ME TRAKTATE TË TJERA: MBËSHTETJA RECIPROKE, KOMPLEMENTARITETI DHE PAVARËSIA**

1. Palët pranojnë që do të përmbushin me mirëbesim detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente dhe të gjitha traktateve të tjera ku ato janë palë. Prandaj, pa e vënë këtë Konventë në varësi të traktateve të tjera,
  - a) ato do të nxisin mbështetjen reciproke ndërmjet kësaj Konvente dhe traktatet e tjera ku ato janë palë; dhe
  - b) palët, gjatë interpretimit dhe zbatimit të traktateve të tjera ku janë palë ose gjatë përfshirjes në detyrime të tjera ndërkombëtare, do të marrin parasysh dispozitat përkatëse të kësaj Konvente.
2. Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si ndryshuese e të drejtave dhe detyrimeve të palëve sipas ndonjë traktati tjetër ku ato janë palë.

## **Neni 21 - KONSULTIMI DHE BASHKËRENDIMI NDËRKOMBËTAR**

Palët marrin përsipër të zhvillojnë objektivat dhe parimet e kësaj Konvente në forume të tjera ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Palët konsultojnë me njëra-tjetrën, sipas rastit, duke pasur parasysh këto objektiva dhe parime.

## **VI. Organet e Konventës**

### **Neni 22 - KONFERENCA E PALËVE**

1. Një Konferencë e Palëve do të krijohet. Konferenca e Palëve është organi plenar dhe suprem i kësaj Konvente.
2. Konferenca e Palëve mbledhet në sesion të zakonshëm çdo dy vjet, sa është e mundur, së bashku me Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s. Ajo mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse vendos, ose nëse Komiteti Ndërqeveritar merr një kërkesë për këtë qëllim të paktën nga një e treta e Palëve.
3. Konferenca e Palëve miraton rregulloren e saj të brendshme.
4. Funkcionet e Konferencës së Palëve, *inter alia*, janë
  - a) të zgjedhë anëtarët e Komitetit Ndërqeveritar;
  - b) të marrë dhe të shqyrtojë raportet e palëve të kësaj Konvente të transmetuara nga Komiteti Ndërqeveritar;
  - c) të miratojë udhëzimet funksionale të përgatitura me kërkesë të saj nga Komiteti Ndërqeveritar;
  - d) të marrë çfarëdo masa të tjera që mund t'i konsiderojë të nevojshme për të përparuar me objektivat e kësaj Konvente.

### **Neni 23 - KOMITETI NDËRQEVERITAR**

1. Një Komitet Ndërqeveritar për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore, i përmendur tani e tutje si "Komiteti Ndërqeveritar", krijohet brenda UNESCO-s. Ai përbëhet nga përfaqësues të 18 shteteve palë të Konventës të zgjedhur për një mandat 4-vjeçar nga Konferenca e Palëve me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente sipas nenit 29.
2. Komiteti Ndërqeveritar mbledhet çdo vit.
3. Komiteti Ndërqeveritar funksionon nën autoritetin dhe drejtimin e Konferencës së Palëve dhe përgjigjet para saj.
4. Anëtarët e Komitetit Ndërqeveritar do të bëhen 24 sapa numri i palëve të Konventës të bëhet 50.
5. Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit Ndërqeveritar bazohet në parimet e përfaqësimit të drejtë gjeografik, si dhe të rotacionit.
6. Pa paragjykuar përgjegjësitë e tjera që i jepen nga kjo Konventë, funksionet e Komitetit Ndërqeveritar janë:
  - a) të zhvillojë objektivat e kësaj Konvente dhe të inkurajojë dhe monitorojë zbatimin e tyre;
  - b) të përgatisë dhe paraqesë për miratimin nga Konferenca e Palëve, me kërkesë të saj, udhëzimet funksionale për përmbushjen dhe zbatimin e dispozitave të Konventës;
  - c) t'i transmetojë Konferencës së Palëve raporte nga palët e Konventës, si dhe komente dhe një përmbledhje të përmbajtjes së tyre;
  - d) të bëjë rekomandimet e duhura që të merren parasysh në situata që sillen në vëmendje të tij nga palët e Konventës, në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës, në veçanti nenin 8;
  - e) të vendosë procedura dhe mekanizma të tjera për konsultim, që synojnë zhvillimin e objektivave dhe parimeve të kësaj Konvente në forume të tjera ndërkombëtare;
  - f) të kryejë detyra të tjera që mund të kërkohen nga Konferenca e Palëve.
7. Komiteti Ndërqeveritar në përputhje me rregulloren e brendshme, mund të ftojë në çdo kohë organizatat apo individët privatë ose publikë për të marrë pjesë në takimet e tij për konsultim mbi çështje specifike.
8. Komiteti Ndërqeveritar përgatitet dhe i paraqet për miratim Konferencës së Palëve rregulloren e tij të brendshme.

## **Neni 24 - SEKRETARIATI I UNESCO-S**

1. Organet e Konventës ndihmohen nga Sekretariati i UNESCO-s.
2. Sekretariati përgatit dokumentacionet e Konferencës së Palëve dhe Komitetit Ndërqeveritar, si dhe rendin e ditës së mbledhjeve të tyre dhe ndihmon dhe raporton për zbatimin e vendimeve të tyre.

## **VII. Klauzola përfundimtare**

### **Neni 25 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve të kësaj Konvente në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës, palët kërkojnë një zgjidhje me anë të negociimit.
2. Nëse palët e interesuara nuk mund të arrijnë një marrëveshje me anë të negociimit, ato mund të kërkojnë së bashku ndërhyrje, ose ndërmjetësim, të një pale të tretë.
3. Nëse ndërhyrja ose ndërmjetësimi nuk ndërmerren, ose nëse nuk arrihet zgjidhje me anë të negociimit, ndërhyrjes apo ndërmjetësimit, një palë mund të bëjë rekurs për pajtimin në përputhje me procedurat e përcaktuara në Aneksin e kësaj Konvente. Palët konsiderojnë në mirëbesim propozimet e bëra nga Komisioni i Pajtitimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
4. Çdo palë, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që nuk e njeh procedurën e pajtitimit të parashikuar më lart. Secila palë që ka bërë një deklaratë të tillë, në çdo kohë mund të tërheqë këtë deklaratë duke njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s.

### **Neni 26 - RATIFIKIMI, PRANIMI, MIRATIMI APO ADERIMI NGA SHTETET ANËTARE**

1. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit nga shtetet anëtare të UNESCO-s në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.
2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

### **Neni 27 - ADERIMI**

1. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet joanëtare të UNESCO-s, por anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjëres prej agjencive të saj të specializuara, që ftohen nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s për të aderuar në të.
2. Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për aderim nga territoret që gëzojnë vetëqeverisje të plotë të brendshme të njohur si të tillë nga Kombet e Bashkuara, por që nuk kanë fituar pavarësinë e plotë në përputhje me Rezolutën 1514 të Asamblesë së Përgjithshme dhe që kanë kompetencë në çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të marrë pjesë në traktate në lidhje me këto çështje.
3. Dispozitat e mëposhtme zbatohen për organizatat rajonale të integritit ekonomik:
  - a) Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për aderim nga çdo organizatë rajonale për integrimin ekonomik, që, përveçse si parashikohet më poshtë, janë krejtësisht të detyrueshme nga dispozitat e Konventës në të njëjtën mënyrë si shtetet palë;
  - b) Në rastin kur një ose më shumë shtete anëtare të një organizate të tillë janë gjithashtu palë të kësaj Konvente, organizata dhe ky/këto shtet/e anëtar/e vendosin për përgjegjësinë e tyre për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente. Kjo shpërndarje e përgjegjësisë bëhet efektive pas përfundimit të procedurës së njoftimit të përshkruar në nënparagrafin (c). Organizata dhe shtetet anëtare nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejta sipas kësaj Konvente njëkohësisht. Përveç kësaj, organizatat rajonale të integritit ekonomik, për çështje brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar me një numër votash të barabartë me atë të shteteve anëtare që janë palë të kësaj Konvente. Një organizatë e tillë nuk e ushtron të drejtën e votës nëse njëra nga shtetet anëtare të saj e ushtron të drejtën e vet dhe anasjelltas;
  - c) Një organizatë rajonale e integritit ekonomik dhe shteti apo shtetet e saj anëtare të saj që kanë rënë dakord për një ndarje të përgjegjësisë si parashikohet në nënparagrafin (b) informon palët për një ndarje të tillë të propozuar të përgjegjësisë në mënyrën e mëposhtme:

- i) në instrumentin e tyre të aderimit, kjo organizatë deklaron me hollësi, ndarjen e përgjegjësive të tyre, në lidhje me çështjet e rregulluara nga Konventa;
  - ii) në rastin e ndonjë ndryshimi të përgjegjësive të tyre përkatëse, organizata rajonale e integritit ekonomik informon depozituesin për një ndryshim të tillë të propozuar të përgjegjësive përkatëse; depozituesi nga ana e tij informon Palët për këtë ndryshim;
- d) Shtetet anëtare të një organizate rajonale të integritit ekonomik që bëhen palë të kësaj Konvente mendohet se vazhdojnë të ruajnë kompetencat mbi të gjitha çështjet në lidhje me të cilat transferimi i kompetencave tek organizata nuk është deklaruar në mënyrë specifike, ose nuk i është bërë i ditur depozituesit;
- e) “Organizatë rajonale e integritit ekonomik” do të thotë një organizatë e përbërë nga Shtetet sovraane, anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjë agjencie tjetër të specializuar të tyre, të cilëve këto shtete u kanë transferuar kompetenca në lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë dhe që janë autorizuar të bëhen palë e saj, në përputhje me procedurat e saj të brendshme.
4. Instrumenti i aderimit depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

### **Neni 28 - PIKA E KONTAKTIT**

Secila palë, kur bëhet palë e kësaj Konvente, cakton një pikë kontakti siç përmendet në nenin 9.

### **Neni 29 - HYRJA NË FUQI**

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të 30-të të ratifikimit, pranimit, miratimit, apo aderimit, por vetëm në lidhje me ato shtete ose organizata rajonale të integritit ekonomik që i kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit atë ditë ose më përpara. Konventa hyn në fuqi në lidhje me çdo palë tjetër tre muaj pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.
2. Për qëllimet e këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të logaritet si shtesë e atyre të depozituar nga Shtetet Anëtare të organizatës.

### **Neni 30 - SISTEMET KUSHTETUESE FEDERALE OSE JOUNITAR**

Duke pranuar që marrëveshjet ndërkombëtare i detyrojnë palët në të njëjtën mënyrë pavarësisht nga sistemet e tyre kushtetuese, dispozitat e mëposhtme zbatohen për palët që kanë një sistem kushtetues federal ose jounitar:

- a) në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i së cilës bëhet sipas juridiksionit ligjor të pushtetit legjislativ federal apo qendror, detyrimet e qeverisjes federale apo qendrore do të jenë të njëjta me ato të palëve që nuk janë shtetet federale;
- b) në lidhje me dispozitat e Konventës, zbatimi i së cilës bëhet sipas juridiksionit të njësive përbërëse të veçanta si shtete, konte, provinca apo kantone të cilat sistemi kushtetues i federatës nuk i detyron të marrin masa legjislative, qeveria federale informon, kur është e nevojshme, autoritetet kompetente të njësive përbërëse si shtete, konte, provinca apo kantone të dispozitave në fjalë, me rekomandim për miratimin e tyre.

### **Neni 31 - DENONCIMI**

1. Çdo palë e kësaj Konvente mund të denoncojë këtë Konventë.
2. Denoncimi bëhet i ditur me anë të një instrumenti me shkrim të depozituar te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.
3. Denoncimi hyn në fuqi 12 muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Denoncimi nuk ndikon në asnjë mënyrë në detyrimet financiare të Palës që denoncon Konventën deri në datën e hyrjes në fuqi të tërheqjes.

### **Neni 32 - FUNKSIONET E DEPOZITUESIT**

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, si depozituesi i kësaj Konvente, njofton shtetet anëtare të organizatës, shtetet që nuk janë anëtare të organizatës dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të përmendura në nenin 27, si dhe Kombet e Bashkuara për depozitimin e të gjitha instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të parashikuara në nenet 26 dhe 27 dhe për denoncimet e parashikuara në nenin 31.

### **Neni 33 - NDRYSHIMET**

1. Një palë e kësaj Konvente, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të propozojë ndryshime të kësaj Konvente. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë njoftim te të gjitha palët. Nëse, brenda gjashtë muajsh nga data e dërgimit të njoftimit, jo më pak se gjysma e palëve përgjigjen në favor të kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në sesionin e radhës të Konferencës së Palëve për diskutim dhe miratim të mundshëm.

2. Ndryshimet miratohen nga dy të tretat e shumicës së palëve të pranishme dhe me votim.

3. Pas miratimit, ndryshimet e kësaj Konvente i paraqiten palëve për ratifikim, pranim, miratim apo aderim.

4. Për palët që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar apo aderuar në to, ndryshimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni me dy të tretat e palëve. Pas kësaj, për çdo palë që ratifikon, pranon, miraton apo aderon një ndryshim, ndryshimi në fjalë hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

5. Procedura e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 nuk zbatohet për ndryshimet e nenit 23 në lidhje me numrin e anëtarëve të Komitetit Ndërqeveritar. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në kohën e miratimit të tyre.

6. Një shtet ose një organizatë rajonale e integritit ekonomik e përmendur në nenin 27 që bëhet palë e kësaj Konvente pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, në mungesë të shprehjes së qëllimeve të ndryshme, konsiderohet të jetë:

a) Palë e kësaj Konvente të ndryshuar; dhe

b) Palë e një konvente të pandryshuar në lidhje me çdo palë që nuk detyrohet nga ndryshimet.

### **Neni 34 - TEKSTE AUTENTIKE**

Kjo Konventë është hartuar në gjuhën angleze, arabe, franceze, kineze, ruse, spanjolle, ku të gjashtë tekstet janë njësoj autentike.

### **Neni 35 - REGJISTRIMI**

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

# Aneks

## PROCEDURA E PAJTIMIT

### Neni 1 - KOMISIONI I PAJTIMIT

Një Komision Pajtimi do të krijohet me kërkesë të njëres prej palëve të mosmarrëveshjes. Komisioni, nëse palët nuk bien dakord ndryshe, do të përbëhet nga pesë anëtarë, dy të emëruar nga çdo palë e interesuar dhe një president i zgjedhur bashkërisht nga këta anëtarë.

### Neni 2 - ANËTARËT E KOMISIONIT

Në mosmarrëveshje ndërmjet më shumë se dy palëve, palët me të njëjtin interes emërojnë anëtarët e tyre të Komisionit me marrëveshje të përbashkët. Kur dy ose më shumë palë kanë interesa të ndryshme ose ekziston një mosmarrëveshje, nëse janë të të njëjtit interes, ata i emërojnë vetë anëtarët e tyre.

### Neni 3 - EMËRIMET

Nëse emërimet nga palët nuk janë bërë brenda dy muajve nga data e kërkesës për të krijuar një Komision Pajtimi, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s i bën këto emërimet brenda një periudhe të mëtejshme dymujore, nëse kjo gjë kërkohet nga palët që bëjnë kërkesën.

### Neni 4 - PRESIDENTI I KOMISIONIT

Nëse një President i Komisionit të Pajtitimit nuk zgjidhet brenda dy muajve të emërimit të fundit prej anëtarëve të Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s cakton një president brenda një periudhe tjetër dymujore, nëse një palë e kërkon këtë gjë.

### Neni 5 - VENDIMET

Komisioni i Pajtitimit vendos me shumicë votash të anëtarëve të tij. Ai, nëse palët nuk vendosin ndryshe, vendos për procedurën e vet. Komisioni jep një propozim për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të cilën palët e konsiderojnë me mirëbesim.

### Neni 6 - MOSMARRËVESHJA

Mosmarrëveshja nëse Komisioni i Pajtitimit ka kompetenca do të vendoset nga Komisioni.

DHJETË ELEMENTE

# DHJETË ELEMENTET

e  
Konventës për  
Mbrojtjen dhe Zhvillimin

e  
Larmisë së  
Shprehjeve  
Kulturore




United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization

MDG:IF  
MIGRATION FUND



United Nations  
ALBANIA





*Dokumenti aktual shpërndahet vetëm për qëllime informacioni dhe nuk synon as të interpretojë e as të plotësojë Konventën për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore (2005).*

*Botimi në shqip i kësaj broshure u mbështet nga Programi Një-OKB «Kultura dhe Trashëgimia për Zhvillimin Ekonomik dhe Social» i cili po zbatohet nga UNESCO - UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë e Sporteve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më mbështetjen e Fondit Spanjoll të Zhvillimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.*

# DHJETË ELEMENTET

e  
Konventës për  
Mbrotjen dhe Zhvillimin  
e

## Larmisë së Shprehjeve Kulturore

1. PSE ËSHTË E NEVOJSHME KONVENTA? .....	2
Për t'i qëndruar besnik mandatit të UNESCO-s Për të kontribuar në zhvillimin e konceptit të kulturës Për të plotësuar me efektivitet veprimtarinë e UNESCO-s për vendosjen e standardeve në fushën e kulturës	
2. CILI ËSHTË QËLLIMI I KONVENTËS? .....	4
3. CILAT JANË OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË KONVENTËS? .....	5
4. CILAT JANË PARIMET DREJTUESE TË KONVENTËS? .....	6
5. CILAT JANË TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE PJESËMARRËSE NË KONVENTË? .....	6
Të drejtat Detyrimet Përkrahja e ndërsjellë, komplementariteti dhe sovraniteti	
6. KUR FILLON TË VEPROJË KONVENTA? .....	9
Ratifikimi Hyrja në fuqi	
7. SI VEPRON KONVENTA? .....	9
Mekanizmat e ndjekjes së zbatimit Mjetet Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	
8. CILËT JANË ROJTARËT KRYESORË TË KONVENTËS? .....	10
9. CILËT JANË PËRFITUESIT KRYESORË TË KONVENTËS? .....	11
10. CILAT JANË MESAZHET KRYESORE TË KONVENTËS? .....	11
SHTOJCA .....	13
DOKUMENTE TË PËRZGJEDHURA TË UNESCO-S MBI LARMINË KULTURORE Dokumente mbi larminë kulturore Dokumente të lidhura me Konventën	

# 1

## Pse është e nevojshme Konventa?

### PËR T'I QËNDRUAR BESNIK MANDATIT TË UNESCO-S

Siç shprehet edhe në Kushtetutën e saj (1946), UNESCO-s, organizatës së vetme të Kombeve të Bashkuara me përgjegjësi për kulturën, i është besuar mandati i dyfishtë i nxitjes së "larmisë së frytshme të kulturave" dhe "rrjedhjes së lirë të ideve me anë të fjalës dhe imazhit".

Këto parime themelore të larmisë dhe lirisë për përparimin e mirëkuptimit reciprok shfaqen vazhdimisht së bashku në qëllimin e Organizatës për të siguruar "orkestrimin e kulturave të veçanta, jo drejt një uniformiteti, por drejt një uniteti në kushtet e larmisë, në mënyrë që qeniet njerëzore të mos burgosen në kulturat e tyre të veçanta por të mund të shkëmbejnë pasuritë e një kulture të vetme botërore të larmishme" (Raporti i Drejtorit të Përgjithshëm, 1947).

UNESCO e ka vënë ndjekjen e këtij qëllimi – që bazohet jo vetëm në pranimin dhe njohjen e larmisë, por edhe në mundësitë për dialog më të gjerë që ai ofron – në qendër të misionit të vet dhe vazhdimisht rinovon qasjet dhe aktivitetet e saj. Kjo ka ardhur si rezultat i pranimit të dinjitetit të barabartë të të gjitha kulturave, të mbrojtjes së pronësisë kulturore, nxitjes së dialogut ndërkulturor, respektimit të të drejtave kulturore, hartimit të politikave në fushën e kulturës për të nxitur diversitetin, nxitjes së pluralizmit konstruktiv, ruajtjes së trashëgimisë kulturore, etj.

Megjithëse për UNESCO-n kultura mbetet një platformë themelore për ndërtimin e paqes në mendjet e burrave dhe grave, transformimi gradual i arenës ndërkombëtare ka çuar në ndryshime në qasjet konceptuale, programet dhe format e veprimit të Organizatës.

### PER TË KONTRIBUAR NË ZHVILLIMIN E KONCEPTIT TË KULTURËS

E konsideruar për një kohë të gjatë vetëm nga këndvështrimi i artit dhe letërsisë, tashmë kultura konsiderohet që mbulon një fushë shumë më të gjerë: "kultura duhet të shihet si një paketë me tiparet dalluese shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale e shoqërisë ose e një grupi shoqëror, dhe që përfshin, përveç artit dhe letërsisë edhe mënyrat e jetesës, mënyrat e të jetuarit së bashku, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet" (Preambula e Deklaratës Universale të UNESCO-s mbi Larminë Kulturore, 2001).

Me një vështrim të mirë, mund të dallohen katër faza kryesore në transformimin e kuptimit dhe funksioneve që i atribuoheshin kulturës. Është e qartë se këto faza nuk janë shumë të ndara nga njera-tjetra dhe se aktivitetet e kryera në çdo fazë janë ndjekur edhe në fazat e mëvonshme:

- (I) zgjerimi i konceptit të kulturës si prodhim i artit duke përfshirë edhe konceptin e identitetit kulturor (ndërmjet viteve 1950 dhe 1960). Gjatë kësaj periudhe, UNESCO u përpoq të mbronte kulturat në përgjigje të situatave të veçanta, të tilla si ato të ardhura si pasojë e dekolonizimit duke njohur dinjitetin e barabartë të kulturave;
- (II) rritja e ndërgjegjësimit për lidhjen jetësore ndërmjet kulturës dhe zhvillimit si themeli i bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërkombëtar me vendet në zhvillim (ndërmjet viteve 1970 dhe 1980) Gjatë kësaj periudhe, UNESCO, duke vazhduar të kryejë aktivitete të filluara më parë, filloi të vinte theksin në huamarrjen e ndërsjellë ndërmjet vendeve dhe shoqërive për të shtruar rrugën drejt partneriteteve të krijuara mbi baza të barabarta;

(III) njohja dhe pranimi i aspiratave dhe i themeleve kulturore në ndërtimin e demokracive (ndërmjet viteve 1980 dhe 1990). Gjatë kësaj periudhe, Organizata tregoi ndërgjegjësime ndaj formave të ndryshme të diskriminimit dhe përjashtimit të përjetuara nga persona që u përkasin minoriteteve, popujve indigjenë dhe grupeve të migrantëve;

(IV) zgjerimi i dialogut ndërmjet kulturave dhe shoqërive të larmishme të konsideruara si trashëgimi i përbashkët e njerëzimit nga Deklarata Universale e UNESCO-s mbi Larminë Kulturore (ndërmjet viteve 1990 dhe 2000). Në koherencë me përkufizimin më të gjerë të konceptit të kulturës, Deklarata trajton sfidën e dyanshme të larmisë kulturore: në një anë, duke siguruar ndërveprim harmonik ndërmjet popujve dhe grupeve me identitete kulturore dinamike të shumta, të ndryshme si edhe me dëshirën për të jetuar së bashku; dhe në anën tjetër, duke mbrojtur larminë e kulturave, d.m.th. larminë e gjerë të formave përmes së cilave kulturat zbulojnë shprehjet e tyre të lidhura me trashëgiminë dhe shprehjet bashkëkohore në kohë dhe hapësirë. Gjatë kësaj periudhe, UNESCO kërkoi të plotësonte nevojat e shoqërive karakteri i shumëllojshëm i të cilave u zgjerua si pasojë e ritmeve të shpejta të globalizimit.

Si një proces i vazhdueshëm, fleksibël dhe në ndryshim, kultura rimodelon trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale duke shpikur forma të reja të shprehjes, duke zbuluar kështu larminë e saj të pafundme. Në një mjedis ndërkombëtar gjithnjë e në ndryshim, UNESCO gjithmonë ka kërkuar të reagojë duke dhënë zgjidhje praktike ndaj sfidave të veçanta që ka paraqitur çdo etapë ndaj zhvillimit të konceptit të kulturës. Larmia kulturore, përmes aftësisë së saj për të nxitur dialogun dhe aftësitë krijuese, është kushti kryesor për paqen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## **PËR TË PLOTËSUAR ME EFEKTIVITET VEPRIMTARINË E UNESCO-S PËR VENDOSJEN E STANDARDEVE NË FUSHËN E KULTURËS**

Sfidat e reja të dala para kulturës që prej krijimit të UNESCO-s kanë bërë që Organizata të veprojë duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion: si një laborator idesh për parashikimin dhe identifikimin e strategjive dhe politikave të përshtatshme kulturore; si një zyrë qendrore për grumbullimin, transmetimin, përhapjen dhe shkëmbimin e informacionit dhe të praktikave më të mira; si një ngritës i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të Shteteve Palë; dhe si një hartues i standardeve duke ftuar Shtetet Palë të bien dakord për rregulla të përbashkëta të hartuara për forcimin e bashkëpunimit të vërtetë ndërkombëtar.

Si hartues i standardeve, UNESCO ka prodhuar shumë instrumente ligjore me fuqi detyruese në të katër fushat kryesore të larmisë krijuese; kryesisht të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, pasurisë kulturore materiale, trashëgimisë kulturore jomateriale dhe krijimtarisë bashkëkohore. Në tërësi janë hartuar shtatë konventa:

- Konventa Universale për të Drejtën e Autorit (1952, e rishikuar në vitin 1971);
- Konventa mbi Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rastin e Konfliktit të Armatosur (1954) (Protokolli 1 në vitin 1954, Protokolli 2 në vitin 1999);
- Konventa mbi Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit dhe Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore (1970);
- Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (1972);
- Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001);
- Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003);
- Konventa për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve (2005).

Konventa për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve është një nga konventat mbi trashëgiminë sepse ajo përqendrohet tek larmia e shprehjeve kulturore ashtu si ato qarkullojnë dhe shkëmbehen me anë të aktiviteteve, mallrave dhe shërbimeve kulturore që janë transmetuesit më bashkëkohorë të kulturës.

Konventa plotëson kështu në mënyrë efektive paketën e instrumenteve ligjore të përgatitur nga UNESCO për zhvillimin e larmisë krijuese dhe nxitjen e një mjedisi botëror në të cilin mbrohet larmia e pasur e krijimtarisë së individëve dhe popujve.

## 2 Cili është qëllimi i Konventës?

Konventa për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore nuk mbulon të gjitha aspektet e larmisë kulturore të trajtuara në Deklaratën Universale të UNESCO-s mbi Larminë Kulturore. Ajo trajton fusha tematike të veçanta të Deklaratës, të tilla si ato të parashikuara në Nenet 8 deri në 11: në njërën anë, nevojën për njohjen e faktit se të mirat dhe shërbimet kulturore përmbajnë identitetet, vlera dhe kuptim dhe si pasojë nuk mund të konsiderohen si të mira të thjeshta ose mallra konsumi si të tjerat; dhe në anën tjetër, nevojën që Palët të marrin të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore duke siguruar rrjedhjen e lire të ideve dhe veprave; dhe së fundi, nevojën për ripërkufizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, gurin themelor të Konventës, meqënëse çdo formë e krijimit mbart farat e një dialogu të vazhdueshëm.

Konventa trajton format e shumta të shprehjeve kulturore që vijnë si rezultat i aktivitetit krijues të individëve, grupeve dhe shoqërive dhe që përcjellin përmbajtjen kulturore përmes kuptimit simbolik, si edhe vlerat artistike e kulturore që rrjedhin prej tyre ose shprehin identitete kulturore. Shprehjet kulturore - pavarësisht nga lloji i mediave dhe teknologjive të përdorura – transmetohen përmes veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore, të cilat, siç pranohet në Konventë, kanë një natyrë të dyfishtë (ekonomike dhe kulturore). Për këtë arsye, ato nuk mund të konsiderohen si objekte të thjeshta të negociatave për tregti.

Qëllimi kryesor i Konventës është forcimi i pesë hallkave të pandashme të të njëjtit zinxhir; kryesisht krijimi, prodhimi, shpërndarja/përhapja, përdorimi dhe gëzimi i shprehjeve kulturore të pëcjella përmes veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore – veçanërisht në vendet në zhvillim.

Duke u përqendruar në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, Konventa pranon se në një botë me kontakte në rritje, çdo individ mund të përdorë më lirisht dhe menjëherë larminë e pasur të shprehjeve kulturore nga vendi ose nga vende të tjera, megjithatë ky potencial akoma nuk është realizuar plotësisht në kontekstin global aktual.

Duhet të vihet në dukje se në terminologjinë e UNESCO-s, termi “mbrojtje” ka të bëjë me miratimin e masave që synojnë ruajtjen, sigurimin dhe shtimin e larmisë së shprehjeve kulturore. Ky është kuptimi me të cilin përdoret ky term në instrumente të ndryshme, si tek Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (1972), Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001) dhe Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003). Termi “mbrojtje” në këtë kontekst nuk ka asnjë prej konotacioneve që ky term mund të përcjellë në sferën tregtare. Kur përdoret i shoqëruar me termin “zhvillim”, ai nënkupton nevojën për të mbajtur gjallë shprehjet kulturore të vëna në rrezik si pasojë e ritmit të shpejtë të globalizimit. Termi “zhvillim” bën thirrje për rigjenerimin e vazhdueshëm të shprehjeve kulturore për të siguruar që ato të mos qëndrojnë të mbyllura nëpër muzeume ose të folklorizohen. Për më tepër, kjo dyshe e termave “zhvillim dhe mbrojtje” është e pandashme. Neni 7 i Konventës përqendrohet tek zhvillimi dhe Neni 8 tek mbrojtja. Kjo e dyta, që përforcon të parën, thekson qartë se të gjitha masat për arritjen e këtij qëllimi duhet të merren “në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente”, që do të thotë duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe traktatet ekzistuese ndërkombëtare.

## 3 Cilat janë objektivat specifike të Konventës?

Përmes objektivit të saj kryesor – mbrojtja dhe zhvillimi i larmisë së shprehjeve kulturore – Konventa përpiket të krijojë një mjedis të përshtatshëm në të cilin mund të afirmohet dhe rinovohet larmia e shprehjeve kulturore në të mirë të të gjitha shoqërive. Po ashtu, Konventa pohon përsëri lidhjet ndërmjet kulturës, zhvillimit dhe dialogut dhe krijon një platformë novative për bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar. Për arritjen e këtij objekti kryesor, Konventa synon:

- të krijojë kushtet që kulturat të zhvillohen dhe të ndërveprojnë lirshëm në një mënyrë me përfitim të ndërsjellë;
- të bëjë të kuptueshme natyrën e veçantë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore si mjete të identitetit, vlerave dhe kuptimit;
- të identifikojë mënyrat e reja për bashkëpunim ndërkombëtar që është themeli i Konventës;
- të pohojë sërish të drejtat sovraane të Shteteve për të ruajtur, miratuar dhe zbatuar politikatat dhe masat që ato i gjykojnë të përshtatshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e shprehjeve kulturore në territorin e tyre, duke siguruar kalimin e lirë të ideve dhe veprave.

Përmes këtij objekti të fundit që përbën edhe fushën e veprimit të Konventës, mbrojtja e larmisë së shprehjeve kulturore mund të konsiderohet më shumë një pjesë e proceseve shumëdimensionale globalizuese sesa pjesë vetëm e proceseve ekonomike.

Kështu, për herë të parë në historinë e të drejtës ndërkombëtare, kultura gjeti vendin e saj të drejtë në axhendën politike si rezultat i shqetësimit për bërjen e globalizimit një proces më njerëzor. Në këtë kontekst proaktiv, kultura është shndërruar në një platformë të drejtë për dialog dhe zhvillim, duke hapur kështu fusha të reja të solidaritetit.

## 4 Cilat janë parimet drejtuese të Konventës?

Një numër parimesh kujtojnë dhe garantojnë që asnjë masë ose politikë e hartuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore nuk mund të shkelë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të tilla si liria e shprehjes, informacionit dhe komunikimit, si edhe aftësia e individëve për të zgjedhur shprehjet kulturore.

Përveç këtyre, parimi i hapjes dhe ekuilibrit siguron që kur shtetet miratojnë masa për të përkrahur larminë e shprehjeve kulturore, ato duhet të kërkojnë të zhvillojnë në mënyrën e duhur hapjen ndaj kulturave të tjera të botës.

Ndërmjet parimeve të tjera janë parimi i komplementaritetit të aspekteve ekonomike dhe kulturore të zhvillimit dhe parimi i zhvillimit të qendrueshëm i cili pasqyrohet qartë në Konventë.

Së fundi, parimi i përdorimit të arsyeshëm është i dyfishtë: përdorimi i një game të pasur dhe të larmishme të shprehjeve kulturore dhe përdorimi nga të gjithë kulturat i mjeteve të përshtatshme të shprehjes dhe përhapjes.

# 5 Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse në Konventë?

Njëri prej objektivave themelore të Konventës është: “të pohojë sërish të drejtat sovrane të Shteteve për të ruajtur, miratuar dhe zbatuar politikat dhe masat që ato i gjejnë të përshtatshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore në territorin e tyre”. Qëllimi për ta pohuar sërish këtë të drejtë nuk ishte vendosja e monopolit të shtetit, por zbatimi në praktikë i qeverisjes kulturore, që do të thotë, ndërveprimi ndërmjet aktorëve individualë dhe institucionalë për ndarjen së bashku të përgjegjësisë për larminë e shprehjeve kulturore.

Konventa përmban një numër të drejtash dhe detyrimesh të Palëve që synojnë të mbrojnë dhe zhvillojnë larminë e shprehjeve kulturore në frymën e përfundimit reciprok dhe komplementaritetit me traktate të tjera ndërkombëtare dhe të drejtuara nga veprimet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

## TË DREJTAT

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përbën një element themelor të Konventës. Në përputhje me Deklaratën Universale të UNESCO-s mbi Larminë Kulturore, Konventa njih lidhjen midis larmisë kulturore dhe realizimit të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ato nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën. Në këtë lidhje, “askush nuk mund të kërkojë të përdorë dispozitat e kësaj Konvente për të shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut ose të garantuara në të drejtën ndërkombëtare ose të kufizojë fushën e veprimit”. Kështu, është eliminuar rreziku i relativizimit kulturor i cili në emër të larmisë mund të njohë praktikat kulturore që shkelin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Konventa lejon Palët të përcaktojnë ekzistencën e situatave të veçanta ku shprehjet kulturore në territorin e tyre janë në rrezik të zhduken, janë nën një kërcënim serioz, ose ndryshe, në nevojë për ruajtje urgjente. Po ashtu, ajo i lejon ato të marrin të gjitha masat e duhura për mbrojtjen dhe ruajtjen e shprehjeve kulturore në situata të tilla.

Më tej, Konventa njih të drejtën sovrane të Palëve për të hartuar dhe zbatuar politikat e tyre kulturore dhe për të miratuar masa që synojnë:

- të ofrojnë mundësi për veprimtari të mira dhe shërbime kulturore në vend midis të gjitha atyre që janë në dispozicion në kuadër të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore kombëtare;
- të sigurojnë për industrinë kulturore të pavarura në vend dhe veprimtaritë në sektorin joformal të drejtën e përdorimit efektiv të mjeteve të prodhimit, shpërndarjes dhe përhapjes të aktiviteteve, të mirave dhe shërbimeve kulturore;
- të inkurajojnë organizatat jofitimprurëse si dhe institucionet publike e private, artistët dhe profesionistët e fushës së kulturës për të zhvilluar dhe nxitur shkëmbimin dhe qarkullimin e lirë të ideve, shprehjeve kulturore dhe veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore;
- të nxisin larminë e medias duke përfshirë transmetimin e shërbimit publik;
- të ofrojnë asistencë financiare publike dhe të krijojnë e përkrahin në formën e duhur institucionet e shërbimit publik.

## DETYRIMET

Konventa parashikon një numër detyrimesh që iu takojnë Palëve të cilave iu bëhet thirrje:

- të përqipen të nxisin në territorin e tyre krijimin e një mjedisi që inkurajon individët dhe grupet shoqërore të krijojnë, prodhojnë, shpërndajnë, përhapin dhe përdorin shprehjet kulturore duke i kushtuar vëmendje rrethanave dhe nevojave të veçanta të grave dhe grupeve shoqërore, përfshirë personat që u përkasin minoritetëve dhe popujve indigjenë në një anë, dhe në anën tjetër, të përdorin shprehje të ndryshme kulturore nga territori i tyre dhe nga vende të tjera të botës;
- të sigurojnë dhënien e transparencën e informacionit përmes ofrimit të informacionit të duhur në raportet e tyre për UNESCO-n çdo katër vjet mbi masat e marra për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;
- të nxisin ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e larmisë së shprehjeve kulturore me anë të programeve edukative dhe programeve për rritjen e ndërgjegjësimit;
- të njohin rolin themelor të shoqërisë civile në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në përpjekjet e Palëve për të arritur objektivat e Konventës;
- të përfshijnë kulturën në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në mbështetje të vendeve në zhvillim me anë të mjeteve të ndryshme, për shembull duke fuqizuar industritë e tyre kulturore, duke ngritur kapacitetet e tyre për të hartuar dhe zbatuar politikat kulturore, duke transferuar teknologjitë, duke ofruar ndihmën financiare dhe trajtimin preferencial për artistët e tyre dhe profesionistë të tjerë kulturorë dhe për të mirat dhe shërbimet kulturore.

## PËRKRAHJA E NDËRSJELLË, KOMPLEMENTARITETI DHE SOVRANITETI

Palët në Konventë ushtrojnë këto të drejta dhe plotësojnë këto detyrime në frymën e përkrahjes së ndërsjellë, komplementaritetit dhe pavarësisë nga instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Zbatimi i dispozitave të Konventës mund të nxjerrë në plan të parë, në një anë, ndërveprimin ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të Palëve të shprehura në këtë traktat të ri, dhe në anën tjetër, të drejtat dhe detyrimet që dalin në angazhime të tjera ndërkombëtare. Për shkak të rritjes së numrit të marrëveshjeve ndërkombëtare, është bërë shumë e nevojshme futja e një klauzole mbi marrëdhënien ndërmjet traktateve me qëllim që të sigurohet mënyra se si rregullat në traktate të ndryshme të lidhen me njëra-tjetrën dhe të qartësohet statusi ligjor i një konvente në lidhje me konventat e tjera.

Kështu, funksioni i një dispozite mbi marrëdhëniet ndërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare duhet të specifikojë marrëdhënien midis këtyre traktateve në rast se ka mbivendosje të të drejtave apo detyrimeve nga burime të ndryshme. Në këtë drejtim, Konventa thekson se Palët duhet të përmbushin me mirëbesim detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente dhe të të gjitha traktateve të tjera ku ato janë palë, pa e vënë këtë Konventë në varësi të ndonjë traktati tjetër. Prandaj, Palët duhet të nxisin mbështetjen e ndërsjellë ndërmjet Konventës dhe traktateve të tjera ku ato janë Palë dhe të marrin parasysh dispozitat përkatëse të Konventës kur interpretojnë apo zbatojnë traktate të tjera ku ato janë Palë, ose kur hyjnë në detyrime të tjera ndërkombëtare. Në të gjitha rastet, Konventa thekson në mënyrë të qartë se asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si ndryshuese e të drejtave dhe detyrimeve të Palëve sipas ndonjë traktati tjetër ku ato janë Palë.



# 6 Kur fillon të veprojë Konventa?

## RATIFIKIMI

Me qëllim që të bëhen Palë në Konventë, Shtetet Anëtare të UNESCO-s duhet të depozitojnë një instrument të ratifikimit, pranimit ose aderimit tek Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s. Shtetet që nuk janë anëtare të UNESCO-s, por janë anëtare të Kombeve të Bashkuara, ose të ndonjëres prej agjencive të saj të specializuara, mund të aderojnë në Konventë nëse ftohen për ta bërë këtë nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s. Siç përcaktohet në Konventë, edhe Organizatat Rajonale të Integritimit Ekonomik mund të aderojnë në Konventë.

## HYRJA NË FUQI

Konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të 30-të të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit tek Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s.

# 7 Si vepron Konventa?

## MEKANIZMAT E NDJEKJES SË ZBATIMIT

Kur Konventa të hyjë në fuqi do të krijohen dy organe:

- Konferenca e Palëve që do të jetë organi plenar dhe suprem i Konventës;
- Komiteti Ndërqeveritar që do të ketë përgjegjësinë për të zhvilluar objektivat e Konventës dhe për të inkurajuar dhe monitoruar zbatimin e saj në frymën e transparencës dhe të vigjilencës.

Mbledhja e parë e Konferencës së Palëve dhe e Komitetit Ndërqeveritar do të luajë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm për hartimin e Rregullave Procedurale të secilës, por edhe për hartimin e udhëzimeve për zbatimin e Konventës. Sekretariati i UNESCO-s ndihmon edhe Konferencën e Palëve, edhe Komitetin Ndërqeveritar. Sekretariati përgatit dokumentacionin për mbledhjet e tyre, ndihmon për zbatimin e vendimeve të tyre dhe raporton në lidhje me to.

## MJETET

Përveç dispozitave mbi të drejtat dhe detyrimet, mjetet materiale të vëna në dispozicion të Palëve nga Konventa do të jenë, në veçanti, Fondi Ndërkombëtar për Larminë Kulturore. Burimet e tij përfshijnë kontributet vullnetare të bëra nga Palët, fonde të caktuara për këtë qëllim nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s dhe kontribute të ndryshme, dhurata dhe trashëgimi.

Në kuadër të zbatimit të Konventës, UNESCO gjithashtu lehtëson mbledhjen, analizimin dhe përhapjen e të gjithë informacionit, statistikave dhe praktikave më të mira mbi larminë e shprehjeve kulturore. Po ashtu, Organizata krijon dhe përditëson një bankë të dhënash mbi sektorë dhe organizata qeveritare, private dhe jofitimprurëse të ndryshme të përfshira në fushën e shprehjeve kulturore.

## ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në Koventë ka një dispozitë për mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mekanizëm që përdoret për çdo mosmarrëveshje të mundshme mbi interpretimin ose zbatimin e rregullave apo parimeve specifike të Konventës nga një këndvështrim kulturor.

Mekanizmi i detyron Palët që në fillim të negociojnë, pastaj i lejon ato të kërkojnë ndërmjetësim ose ndërhyrje. Nëse zgjidhja e mosmarrëveshjeve nuk mund arrihet me anë të një ose më shumë prej këtyre mjeteve, mund të fillohet procedura e pajtimit. Megjithatë, Palët mund të vendosin të mos e njohin këtë procedurë .

## 8 Cilët janë rojtarët kryesorë të Konventës?

Funksionimi normal i Konventës kërkon pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve kulturorë:

- aktorët publikë (Shteti dhe institucionet e tij) sovraniteti i të cilëve njihet nga Konventa;
- aktorët e shoqërisë civile, roli themelor i të cilëve për mbrojtjen dhe zhvillimin e shprehjeve kulturore duhet të njihet nga Shtetet Palë të Konventës. Njëkohësisht, Konventa e inkurajon shoqërinë civile të marrë pjesë aktive në ndjekjen e objektivave të Konventës;
- aktorët privatë, kryesisht ndërmarrjet dhe industrinë kulturore, veçanërisht ato të vendeve në zhvillim, që Konventa kërkon të nxisë me dispozitat e saj mbi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin për zhvillim;
- personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë njihen si aktorë kryesorë nga Konventa. Për këtë qëllim, Palët ftohen t'u kushtojnë vëmendjen e duhur rrethanave dhe nevojave të tyre të veçanta në fushën e krijimit.

## 9 Cilët janë përfituesit e Konventës?

Përfituesit e Konventës janë të panumërt:

- në frymën e saj, nga Konventa përfitojnë të gjithë individët dhe shoqëritë sepse ajo synon të sigurojë që ata të gëzojnë lirinë e shprehjeve kulturore në interes të hapjes, balancës dhe lirisë;
- duke njohur kontributin e rëndësishëm të artistëve dhe të të gjithë atyre që marrin pjesë në proceset krijuese, të komuniteteve dhe organizatave kulturore që i mbështesin ata, nga Konventa përfitojnë veçanërisht profesionistët në fushën e kulturës;

Për më tepër, disa prej dispozitave të Konventës identifikojnë përfitues specifikë:

- vende që kanë mungesë kapacitetesh për të prodhuar dhe përhapur shprehjet e tyre kulturore, veçanërisht vendet në zhvillim; Konventa parashikon forma të ndryshme ndihme për këto masa (ndihmën zyrtare për zhvillim, kredi me interesa të ulëta, grante, etj.) dhe trajtim preferencial për artistët dhe profesionistët të tjerë kulturorë nga këto vende;
- grupe të ndryshme shoqërore, përfshirë gratë dhe persona që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë, duke përfshirë tek detyrimet e Palëve detyrimin për krijimin e një mjedisi të favorshëm për krijimin, prodhimin, shpërndarjen dhe gëzimin e shprehjeve kulturore për këto grupe.

# 10 Cilat janë mesazhet kryesore të Konventës?

Konventa thekson faktin se krijimtaria kulturore që përbën një aspekt të larmisë kulturore është ngulitur në të gjithë njerëzimin. Ajo shtron rrugën për forcimin e marrëdhënieve njerëzore në një botë të globalizuar që ndonjëherë i mungon solidariteti. Megjithatë asnjëherë nuk ka pasur një numër kaq të madh veprash në anën e ofertës, Konventa synon të sigurojë që ato të gëzohen nga sa më shumë njerëz që të jetë e mundur dhe që zgjedhjet që u vihen atyre në dispozicion të mos kufizohen vetëm tek një numër i vogël veprash, me origjinë në vend ose të huaj.

Konventa kërkon të mbrojë pasurinë kulturore e cila e merr aftësinë e saj për të ndërvepruar, për tu përtëritur dhe transmetuar nga burimet e brendshme dhe të mbarë botës. Përhapja më e madhe e kësaj larmie krijuese, e ardhur nga burime të brendshme apo të jashtme, sjell përparësi kulturore dhe shoqërore, duke kaluar kështu përtej dimensionit të saj thjesht tregtar.

Konventa nuk synon të kontrollojë ose të kufizojë larinë e shprehjeve kulturore. Ajo synon të zhvillojë dhe mbrojë larinë e shprehjeve kulturore. Përkufizimi i termit “mbrojtje” siguron që veprimi i kryer dhe mjetet e përdorura nga Palët – e drejta sovraane e të cilave njihet - do të synojnë të ruajnë, sigurojnë dhe shtojnë larinë e shprehjeve kulturore dhe jo të kufizojnë rrjedhjen mbi bazën e proteksionizmit apo izolimit mbështetur tek identiteti. Po ashtu, në Konventë janë përcaktuar një numër garancish të cilat, sipas “parimit të hapjes dhe ekuilibrit” sigurojnë që masat e marra nga Shtetet duhet gjithashtu të nxisin “hapjen ndaj kulturave të botës”.

Veç kësaj, Konventa i lejon Palët të marrin masa mbrojtëse në rastet kur shprehjet kulturore janë në rrezik për zhdukje ose nën kërcënim të rëndë, dhe inkurajon fuqimisht bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim që të ndihmohen vendet në zhvillim që gjenden në situata të tilla. Në të gjitha rastet, objektivat dhe parimet e përcaktuara në Konventë duhet të zbatohen sepse ato synojnë të nxisin shkëmbimet e vërteta ndërmjet shprehjeve kulturore të të gjithë popujve dhe të shtojnë larinë e shprehjeve të tilla në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Duke bërë kështu, Konventa ndihmon të forcohen marrëdhëniet ndërmjet “kulturës dhe zhvillimit”, termi i dytë kuptohet në sensin e tij material dhe simbolik: i referohet, në një anë, rritjes ekonomike, dhe në anën tjetër, arritjes së gëzimit të të drejtave themelore, hapjes ndaj botës pa humbur pikat e tyre të referencës. Ajo gjithashtu vë themelet për një formë të re bashkëpunimi dhe një solidaritet lokal, rajonal dhe ndërkombëtar duke nxitur shkëmbimet dhe partneritetet, veçanërisht në favor të vendeve ku shprehjet kulturore janë në rrezik.

Së fundi, Konventa njeh dhe përcakton si një të drejtë format e reja të dialogut që vijnë nga të mirat dhe shërbimet kulturore që përhapin shprehjet kulturore dhe i vënë ato në dispozicion të të gjithëve. Çdo formë krijimi shërben si një pikë takimi, hap horizonte të reja, transformon mendimet dhe zgjeron hapësirën e lirisë dhe të zgjedhjeve tona, duke ndihmuar kështu të formojnë një botë më njerëzore. Çdo formë krijimi krijon një lidhje midis rajoneve, ndërmjet individëve dhe ndërmjet brezave, duke thurur kështu strukturën e trashëgimisë së të nesërme.

Duke u përqendruar në larinë e shprehjeve kulturore, Konventa jep kontributin e vet për bërjen e “mbrojtjes së larmisë kulturore një domosdoshmëri etike, të pandashme nga respekti për dinjitetin njerëzor”. Duke e kthyer edhe një herë vëmendjen e tyre tek shprehjet kulturore dhe tek respekti i plotë për përhapjen e tyre të lirë, Shtetet Anëtare të UNESCO-s kanë treguar sensin e tyre të përgjegjësisë për këtë burim të pashtershëm të shpikjeve, novacioneve dhe imagjinatës që nxit kuptimin dhe dialogun e ndërsjellë mes kulturave.

# Shtojca

## DOKUMENTE TË ZGJEDHURA TË UNESCO-S MBI LARMINË KULTURORE

### DOKUMENTE MBI LARMINË KULTURORE

*Culture, Creativity and Markets, World Culture Report, Paris, 1998.*

*Cultural Diversity, Conflict and Pluralism, World Culture Report, Paris, 2000.*

*Culture, Trade and Globalization, Questions and Answers, Paris, 2000.*

*International Flows of Selected Cultural Goods, 1980-98, Institute for Statistics, Paris, 2000.*

*UNESCO and the Issue of Cultural Diversity: Review and Strategy, 1946-2004, Revised Version, Paris, 2004.*

*International Flows of Selected Cultural Goods and Services 1994-2003, Institute for Statistics/Sector for Culture, Montreal/Paris, 2005.*

### DOKUMENTE TË LIDHURA ME KONVENTËN

*Preliminary study on the technical and legal aspects relating to the desirability of a standard-setting instrument on cultural diversity, Decision 166/EX/3.4.3, Paris, April 2003.*

*Desirability of drawing up an international standard-setting instrument on cultural diversity, 32 C/52, , Paris, 18 July 2003.*

*Desirability of drawing up an international standard-setting instrument on cultural diversity, Resolution 32 C/34, Paris, 17 October 2003.*

*Report First Meeting of Experts (category VI) on the First Draft of an International Convention on the Protection of the Diversity of Cultural Contents and Artistic Expressions, UNESCO Headquarters, 17-20 December 2003, CLT/CPD/2003-608/01, Paris, 20 February 2004.*

*Progress Report on the preparation of a preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, 169 EX/ Decision 3.7.2, Paris, April 2004.*

*Report Second Meeting of Experts (Category VI) on the Preliminary Draft on the Convention on the Protection of the Diversity of Cultural Contents and Artistic Expressions, 30 March – 3 April 2004, CLT/CPD/2004/602/6, Paris, 14 May 2004.*

<sup>11</sup> *Report Third Meeting of Experts (Category VI) on the Preliminary Draft on the Convention on the Protection of the Diversity of Cultural Contents and Artistic*

*Expressions*, 28 - 31 May 2004, CLT/CPD/2004/603/5, Paris, 23 June 2004.

*Preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, Preliminary report of the Director-General, CLT/CPD/2004/CONF.201/1, Paris, July 2004.*

*Preliminary draft of a convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, CLT/CPD/2004/CONF.201/2, Paris, July 2004.*

*First session of the intergovernmental meeting of experts on the Preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, Report by the Secretariat, CLT-2004/CONF.201/9, Paris, November 2004.*

*Preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, Drafting Committee, Part I to V, Paris, December 2004, CLT/CPD/2004/CONF.607/1 to CLT/CPD/2004 CONF.607/5.*

*Preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, Text revised by the Drafting Committee, CLT/CPD/2004/CONF.607/6, Paris, December 2004.*

*Preliminary report of the Director-General containing two preliminary drafts of a Convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, CLT/CPD/2005/CONF.203/6, Paris, 3 March 2005.*

*Report by the Director-General on the progress towards the draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, 171 EX/Decision 19, April 2005.*

▶ *Appendix 2 to the Preliminary report of the Director-General containing two preliminary drafts of a Convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, Consolidated text prepared by the Chairperson of the intergovernmental meeting, CLT/CPD/2005/CONF.203/6 - Add, Paris, 29 April 2005.*

*Preliminary report by the Director-General setting out the situation to be regulated and the possible scope of the regulating action proposed, accompanied by the Preliminary draft of a convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, 33 C/23, Paris, 4 August 2005.*

*Report by the Director-General on the progress achieved during the third session of the intergovernmental meeting of experts on the preliminary draft convention on the protection of the diversity of cultural contents and artistic expressions, 172 EX/Decision 19, September 2005.*

*Convention on the Protection and Promotion of the Diversity of Cultural Expressions, 20 October 2005, 33rd session of the General Conference.*

30 PYETJET

# 30 PYETJET E BËRA MË SHPESH NË LIDHJE


me  
Konventën për  
Mbrojtjen dhe Zhvillimin  
e

Larmisë së  
Shprehjeve  
Kulturore



United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization





*Dokumenti aktual shpërndahet vetëm për qëllime informacioni dhe nuk synon as të interpretojë e as të plotësojë Konventën për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore (2005).*

*Botimi në shqip i kësaj broshure u mbështet nga Programi Një-OKB «Kultura dhe Trashegimia për Zhvillimin Ekonomik dhe Social» i cili po zbatohet nga UNESCO - UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë e Sporteve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më mbështetjen e Fondit Spanjoll të Zhvillimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.*

# 30 PYETJET E BËRA MË SHPESH NË LIDHJE

.....  
me  
Konventën për  
Mbrojtjen dhe Zhvillimin  
e

## Larmisë së Shprehjeve Kulturore

KONTEKSTI.....	2
1. Çfarë është Konventa për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore? .....	2
2. Çfarë kuptohet me “shprehje kulturore”? .....	2
3. Cilat janë vështirësitë me të cilat përballet Konventa? .....	3
4. Cilat janë konceptet themelore të Konventës .....	3
5. Përse Konventa nuk e trajton larminë kulturore si një të tërë? .....	3
6. Cilat ishin fazat që çuan në miratimin e Konventës? .....	4
TEKSTI .....	5
7. Cilat janë objektivat e Konventës? .....	5
8. Cila është fusha e zbatimit të Konventës? .....	5
9. Çfarë të drejtash u siguron Konventa Palëve?.....	5
10. Cilat janë detyrimet e Palëve në Konventë? .....	6
11. Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas Konventës? .....	7
12. Cilat janë parimet drejtuese të Shteteve Palë në Konventë.....	7
VEPRIMI I KONVENTËS .....	8
13. Kur fillon të veprojë Konventa? .....	8
14. Cila është procedura për ratifikimin e Konventës? .....	8
15. Cilët janë mekanizmat pasues? .....	9
16. Çfarë është Konferenca e Palëve? Cilat janë funksionet e saj? .....	9
17. Çfarë është Komiteti Ndërqeveritar? Cilat janë funksionet e tij? .....	9
18. Cilat janë funksionet e Sekretariatit të UNESCO-s? .....	9
19. Cili është roli i shoqërisë civile në zbatimin e Konventës? .....	10
20. Çfarë është Fondi Ndërkombëtar për Larminë Kulturore? .....	10
21. Si funksionon mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve? .....	10
22. A i përcakton Konventa marrëdhëniet e saj me instrumente të tjerë ndërkombëtare ligjore? .....	11
23. Si i trajton Konventa marrëdhëniet me instrumente të tjera ndërkombëtare? .....	11
PYETJE TË TJERA .....	12
24. Cilat janë përparësitë e ratifikimit të kësaj Konvente? .....	12
25. Cilat janë përfitimet për vendet në zhvillim? .....	12
26. A merret Konventa me personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë? .....	12
27. A e trajton Konventa pronësinë intelektuale? .....	13
28. A e trajton Konventa larminë gjuhësore? .....	13
29. A e kufizon Konventa rrjedhjen e lirë të ideve dhe informacionit? A mund të përdoret ajo për të justifikuar censurën? .....	13
30. A mundet që Konventa të ketë ndikim në regjimin tregtar të Shteteve Palë? .....	14



## 1 ÇFARË ËSHTË KONVENTA PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E LARMISË SË SHPREHJEVE KULTURORE?

Sot, idetë dhe shprehjet kulturore – pavarësisht nëse janë në formën e librave, CD-ve, kasetave, shfaqjeve të drejtpërdrejta, programeve në radio dhe television, filmave, videove, DVD-ve ose internetit – transmetohen në një masë të madhe përmes formave të prodhimit dhe shpërndarjes gjithnjë e më shumë teknike e industriale. Duke marrë në konsideratë këtë ndryshim rrënjësor në mënyrat e krijimit dhe të gëzimit të kulturës, lind pyetja nëse çdo njeri përfiton të njëjtat avantazhe.

Konventa për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore, e miratuar në vitin 2005 nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, është një instrument ligjor me fuqi detyruese. Qëllimi i saj është mbrojtja dhe zhvillimi i shprehjeve kulturore, veçanërisht ashtu si ato mishërohen dhe përçohen në veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore që janë mjetet e kulturës bashkëkohore. Konventa synon të krijojë një kuadër ligjor të favorshëm për të gjithë mbi prodhimin, shpërndarjen/përhapjen, përdorimin dhe gëzimin e një game të gjerë të shprehjeve kulturore me origjinë të ndryshme.

Konventa vë në dukje rolin vendimtar të politikave kulturore dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Shtetet kanë rënë dakord mbi nevojën urgjente për këtë instrument duke mbajtur parasysh faktin se proceset e shpejta të globalizimit kanë prirje të nxjerrin në pah pabarazitë ndërmjet vendeve që nuk kanë dhe vendeve që kanë kapacitete për të krijuar, prodhuar dhe përhapur shprehjet e tyre kulturore.

## 2 ÇFARË KUPTOHET ME “SHPREHJE KULTURORE”?

Termi “shprehje kulturore” i referohet mënyrave të ndryshme në të cilat merr formë dhe shfaqet krijimtaria e individëve dhe grupeve shoqërore. Këto shfaqje përfshijnë shprehjet e transmetuara me anë të fjalëve (letërsia, përrallat ...), tingullit (muzika...), imazheve (fotografitë, filmat ...) – në çdo format (të printuar, audiovizual, dixhital etj.) – ose me anë të veprimtarive (kërcimi, teatri...) ose objekteve (skulpturat, pikturat...).

Sot, prodhimi dhe përhapja e shprehjeve kulturore gjithnjë e më shumë përputhet me një logjikë industriale dhe ekonomike. Kështu mund të thuhet se shprehjet kulturore transmetohen në një masë të madhe me anë të atyre “veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore” të cilat janë bërë mjetet kryesore të kulturës. Po ashtu, ato kanë fituar një rëndësi të madhe ekonomike dhe janë bërë pjesë kryesore të tregtisë ndërkombëtare. Natyra e dyfishtë ekonomike dhe kulturore e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore është njohur gjithnjë e më shumë. Kjo së bashku me faktin që si mbartës të identitetit, vlerave dhe kuptimit, ato nuk mund të trajtohen si mallra të thjeshta.

Duke u përqendruar në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, Konventa e vitit 2005 merr në konsideratë faktin se në një botë me kontakte në rritje, çdo individ mund të përdorë më lirisht dhe menjëherë larminë e pasur të shprehjeve kulturore nga vendi ose nga vende të tjera dhe se kjo mundësi duhet të realizohet në një botë që ka nevojë për një solidaritet më të madh.

## 3 CILAT JANË VËSHTIRËSITË ME TË CILAT PËRBALLET KONVENTA?

Konventa synon t’i japë kulturës vendin e saj të duhur në axhendën politike ndërkombëtare, veçanërisht duke njohur vlerën e saj simbolike dhe se ajo është e pandashme nga mirëqenja njerëzore.

Më saktësisht, Konventa trajton një numër vështirësish me të cilat përballen shprehjet kulturore:

- të njihet natyra e dyfishtë ekonomike dhe kulturore e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore të cilat përmbajnë dhe transmetojnë shprehjet kulturore, dhe duke bërë këtë gjë, ato përbëjnë mjete të identitetit, vlerave dhe kuptimit pavarësisht vlerës së tyre tregtare.

- të shmangë rrezikimin e shprehjeve kulturore të grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë ato të personave që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë.
- të menaxhojë rreziqet e rrjedhjeve të pabalancuara të shprehjeve kulturore ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim.

## 4 CILAT JANË KONEPTET THEMELORE TË KONVENTËS?

Konventa është në përputhje me mendimin dhe veprimtarinë e UNESCO-s. Në lidhje me këtë, Kushtetuta e UNESCO-s i cakton asaj mandatin e dyfishtë të "ruajtjes së [...] diversitetit të frytshëm të kulturave [...] të Shteteve Anëtare" dhe të "avancimit të njohurive dhe mirëkuptimit reciprok të popujve përmes mjeteve të komunikimit masiv, dhe për këtë qëllim, rekomandon marrëveshje të tilla që mund të jenë të nevojshme për të nxitur rrjedhjen e lirë të ideve me anë të fjalës dhe imazhit".

Që nga viti 1946 e deri në ditët e sotme, çështja e larmisë kulturore është trajtuar në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar nga Organizata sipas situatave të ndryshme historike ose politike. Që prej vitit 1990, në përgjigje të përsheptimit të proceseve globalizuese, larmia kulturore doli në krye veçanërisht gjatë Konferencës Ndërqeveritare mbi Politikën Kulturore për Zhvillim (Stokolm, 1998).

Plani i Veprimit të saj nxiti organizimin e shumë aktiviteteve, simpoziumeve dhe tavolinave të rrumbullakta të Ministrave të Kulturës si edhe botimin e një raporti periodik mbi kulturën. U botuan dy Raporte Botërore mbi Kulturën: Kultura, krijimtaria dhe tregjet (1998) dhe Larmia, konflikti dhe pluralizmi kulturor (2000). E nxitur nga mësimet e nxjerra nga puna e kryer, në vitin 2001 Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s miratoi në mënyrë unanime Deklaratën Universale të UNESCO-s mbi Larminë Kulturore. Duke e ngritur larminë kulturore në statusin e "trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit", Deklarata pranon nevojën, në njërin anë, të sigurojë një bashkëekzistencë harmonike ndërmjet individëve dhe grupeve me horizonte të ndryshme kulturore, dhe, në anën tjetër, të mbrojë kapacitetin krijues përmes formave të shumta materiale dhe jomateriale të kulturave.

## 5 PËRSE KONVENTA NUK E TRAJTON LARMINË KULTURORE SI NJË TË TËRË?

Është e vërtetë se Konventa trajton vetëm një aspekt të larmisë kulturore ashtu siç përcaktohet në Deklaratën e vitit 2001 në nenet e mëposhtme: 8 (të mirat dhe shërbimet kulturore si mallra të veçanta), 10 (forcimi i kapaciteteve për krijimin dhe përhapjen në nivel global); dhe 11 (krijimi i partneriteteve ndërmjet sektorëve publikë e privatë dhe shoqërisë civile). Aspekte të tjera të larmisë kulturore tashmë janë të trajtuara në gjashtë konventa ndërkombëtare që janë hartuar nga UNESCO: Konventa Universale për të Drejtën e Autorit (1952, e rishikuar në vitin 1971); Konventa mbi Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rastin e Konfliktit të Armatosur (protokolli i parë 1954, protokolli i dytë 1999); Konventa mbi Mjetet e Ndalimit dhe të Parandalimit të Importit dhe Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore (1970); Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (1972); Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001);

Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003). Sot, tre shtyllat e ruajtjes dhe zhvillimit të larmisë krijuese janë: Konventa e vitit 1972 mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore; Konventa e vitit 2003 mbi Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale; dhe Konventa e vitit 2005 mbi Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore. Kjo e fundit ndryshon nga dy konventat e tjera mbi trashëgiminë sepse ajo përqëndrohet në mënyrë të veçantë tek larmia e shprehjeve kulturore të përhapura dhe të vëna në dispozicion me anë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore.

## 6 CILAT ISHIN FAZAT QË ÇUAN NË MIRATIMIN E KONVENTËS?

Puna përgatitore për hartimin e tekstit paraprak të Konventës u krye për një periudhë kohore prej dy vjetësh. Bisedimet u filluan që me miratimin e Rezolutës 32C/34 në sesionin e 32-të të Konferencës së Përgjithshme (tetor 2003). Në përputhje me këtë rezolutë dhe me procedurat për hartimin dhe miratimin e instrumenteve ndërkombëtare në UNESCO, Drejtori i Përgjithshëm në fillim u besoi 15 ekspertëve të pavarur detyrën për të kryer reflektimin paraprak dhe për t'i dorëzuar atij rekomandimet për përgatitjen e një projekti paraprak të Konventës për Mbrojtjen e Larmisë së Përmbajtjeve Kulturore dhe Shprehjeve Artistike. Gjatë tri takimeve, ekspertët e pavarur arritën të hartonin një tekst të hollësishëm.

Pas këtyre takimeve, Z. Koichiro Matsuura, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, në mes të muajit korrik 2004 u dërgoi Shteteve Anëtare një raport paraprak të shoqëruar me tekstin paraprak të konventës me qëllim që të mblidhte komentet dhe vëzhgimet e tyre deri në mes të muajit nëntor 2004. Njëkohësisht, ai kreu konsultime me organizata të tjera qeveritare ndërkombëtare: Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD) dhe Organizatën Botërore për Pronësinë Intelektuale (WIPO), të cilat i dërguan komentet e tyre mbi tekstin paraprak të konventës në nëntor 2004.

Tre sesionet e takimit ndërqeveritar të ekspertëve u kryen në periudhën ndërmjet muajit shtator 2004 dhe qershor 2005 në mënyrë që t'u jepnin mundësi përfaqësuesve të Shteteve Anëtare të UNESCO-s të diskutonin dhe përmirësonin tekstin e hartuar nga grupi i ekspertëve të pavarur. Përsa i përket takimeve të Komisionit të hartimit të draftit të krijuar në sesionin e parë ndërqeveritar, këto takime bënë të mundur përfundimin e tekstit të draftit paraprak të Konventës. Këto faza të ndryshme arritën kulmin me miratimin e Konventës për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore në nëntor 2005 nga Konferenca e Përgjithshme në sesionin e vet të 33-të (148 Shtete votuan pro, 2 shtete votuan kundër dhe 4 abstenuan).

Për më shumë informacion mbi secilën fazë të procesit, shikoni [www.unesco.org/culture/diversite/convention](http://www.unesco.org/culture/diversite/convention)

## TEKSTI

## 7 CILAT JANË OBJEKTIVAT E KONVENTËS?

Në ndjekje të objektivave të saj – mbrojtja dhe zhvillimi i larmisë së shprehjeve kulturore – Konventa synon të krijojë një kuadër ligjor të favorshëm për shfaqjen dhe përtëritjen e larmisë së shprehjeve kulturore duke përfunduar shoqëritë në tërësi (Neni 1). Në mënyrë më specifike, Konventa kërkon të sigurojë kushte të favorshme për krijimin, prodhimin, shpërndarjen/përhapjen e një larmie më të madhe të shprehjeve kulturore me origjinë të ndryshme së bashku me përdorimin dhe gëzimin e këtyre shprehjeve kulturore nga të gjithë. Për këtë qëllim, Konventa synon:

- të pohojë sërish të drejtën sovranë të Shteteve për të hartuar politika kulturore;
- të njohë natyrën e veçantë të të mirave dhe shërbimeve kulturore si mjete të identitetit, vlerave dhe kuptimit; dhe
- të forcojë bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërkombëtar me qëllim përkrahjen e shprehjeve kulturore të të gjithë vendeve, veçanërisht të atyre ku të mirat dhe shërbimet kulturore nuk kanë akses në mjetet e krijimit, prodhimit e shpërndarjes në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Në këtë mënyrë, Konventa kërkon të ndihmojë nxitjen e dialogut ndërkulturor mbi bazën e dinjitetit të barabartë të të gjitha kulturave dhe të inkurajojë zhvillim të qëndrueshëm i cili kuptohet jo vetëm në lidhje me zhvillimin ekonomik por edhe si një mjet për arritjen e një jete të kënaqshme intelektuale, morale dhe shpirtërore.

## 8 CILA ËSHTË FUSHA E ZBATIMIT TË KONVENTËS?

Konventa përcakton se çfarë mund të bëjë një Shtet Palë i Konventës për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore. Si pasojë, Konventa zbatohet "për politikatat dhe masat e miratuara nga Palët në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore" (Neni 3). Për qëllime të kësaj Konvente, "politikatat dhe masat kulturore" përcaktohen si "ato politika dhe masa që lidhen me kulturën, në nivel lokal, kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar të cilat ose janë përqendruar në kulturën si të tillë, ose janë hartuar për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në shprehjet kulturore të individëve, grupeve ose shoqërive duke përfshirë krijimin, prodhimin, ndarjen, shpërndarjen dhe të drejtën e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore" (Neni 4.6). Këto politika dhe masa kulturore, linjat kryesore të të cilave parashikohen në Pjesën IV të Konventës të titulluar "Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve", ndërmjet të tjerave, mund të kenë qëllim forcimin e industrive kulturore, përkrahjen e artistëve dhe profesionistëve kulturorë ose rritjen e edukimit për artet.

## 9 ÇFARË TË DREJTASH U SIGURON KONVENTA PALËVE?

Konventa u jep Palëve të drejtën sovrane për të formuluar dhe zbatuar politikatat e tyre kulturore dhe për të miratuar masat për të mbrojtur dhe zhvilluar larminë e shprehjeve kulturore në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, parimet e së Drejtës Ndërkombëtare dhe instrumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht (Neni 5). Konventa ofron një listë të masave që Palët mund të miratojnë për këtë qëllim (Neni 6):

- masa rregullatore që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore;
- masa që sigurojnë mundësi që veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore në vend të gjejnë vendin e tyre në gamën e gjerë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore në dispozicion;
- masa që synojnë të sigurojnë për industritë kulturore të pavarura në vend dhe për veprimtaritë në sektorin joformal të drejtën e përdorimit efektiv të mjeteve të prodhimit, shpërndarjes dhe përhapjes së veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore;
- masa që synojnë të sigurojnë ndihmë publike financiare;
- masa që synojnë të inkurajojnë të gjithë aktorët kulturorë (institucionet publike dhe private, artistët, profesionistët kulturorë, organizatat jofitimprurëse) të zhvillojnë dhe të nxisin shkëmbimin dhe qarkullimin e lirë të ideve dhe shprehjeve kulturore;
- masa që synojnë të përkrahin institucionet publike;
- masa që synojnë të inkurajojnë dhe të përkrahin artistët dhe të gjithë krijuesit;
- masa që synojnë të rrisin larminë e medias, veçanërisht të shërbimeve publike të transmetimit.

Megjithatë, ushtrimi i kësaj të drejte duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Konventës, veçanërisht me "Objektivat" dhe "Parimet Drejtuese" (shikoni gjithashtu Pyetjet 7 dhe 13).

Po ashtu, Konventa i lejon Palët të përcaktojnë ekzistencën e situatave të veçanta në të cilat shprehjet kulturore në territorin e tyre janë në rrezik të zhduken, janë nën kërcënim të rëndë, ose ndryshe, në nevojë për mbrojtje urgjente, dhe kështu të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dhe ruajtur shprehjet kulturore në situata të tilla.

## 10 CILAT JANË DETYRIMET E PALËVE NË KONVENTË?

Palët në Konventë marrin përsipër të mbrojnë dhe zhvillojnë, në vend dhe në vende të tjera, larminë e shprehjeve kulturore në përputhje me dispozitat e Konventës (Neni 5).

Një prej angazhimeve të para është të zhvillojnë larminë e shprehjeve kulturore (Neni 7). Palëve iu kërkohet të marrin masa për të krijuar një mjedis që inkurajon individët dhe grupet shoqërore të krijojnë, prodhojnë, shpërndajnë, përhapin dhe përdorin shprehjet e tyre kulturore si edhe gamën e gjerë të shprehjeve kulturore në botë. Po ashtu, Palët marrin përsipër të ndajnë informacionin dhe të sigurojnë transparencën (Neni 9). Ky angazhim në lidhje me transparencën i detyron Palët që të dorëzojnë një raport në UNESCO një herë në katër vjet mbi masat e marra për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore brenda territorit të tyre dhe në nivel ndërkombëtar. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut janë gjithashtu detyrime që kanë Palët (Neni 10). Për arritjen e këtij qëllimi, Palëve u kërkohet të inkurajojnë dhe nxisin kuptimin e rëndësisë së mbrojtjes dhe zhvillimit të larmisë së shprehjeve kulturore dhe të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale. Së fundi, Palët marrin detyrime në nivel ndërkombëtar në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet vendeve (Pyetja 11) dhe për rolin që duhet të luajë shoqëria civile (Pyetja 19).

## 11 CILI ËSHTË ROLI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR SIPAS KONVENTËS?

Konventa i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit ndërkombëtar i cili duhet të nxitet nga Palët (Nenet 12 dhe 14). Solidariteti ndërkombëtar është një përgjigje efektive ndaj pabarazive ndërmjet Shteteve në lidhje me masat në dispozicion për shprehjet kulturore. Nenet e përmendura më sipër parashtrojnë linjat praktike të veprimit mbi bazën e partneritetit. Ato synojnë të rrisin kapacitetet për krijimin, prodhimin, shpërndarjen dhe përhapjen e shprehjeve kulturore, në mënyrë që Palët, veçanërisht ato ku shprehjet kulturore janë në rrezik dhe/ose nuk kanë mjetet për të siguruar mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre të mund të mbështeten në solidaritetin ndërkombëtar. Ky solidaritet, siç tregohet për shembull përmes trajtimit preferencial për vendet në zhvillim (Neni 16) dhe gatishmërisë për të ofruar ndihmë të ndërsjellë në situata ku kërcënohen seriozisht shprehjet kulturore (Neni 17), synon të pakësojë në mënyrë konkrete rreziqet për pabarazi që mund të sjellin proceset globalizuese për larminë e shprehjeve kulturore.

## 12 CILAT JANË PARIMET DREJTUESE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS NGA SHTETET PALË?

Të drejtat që i jepen Palëve dhe agazhimet e tyre përkatëse nuk do të zbatohen në çfarëdo mënyre që dëshirojnë Palët. Të drejtat duhet të ushtrohen dhe detyrimet të merren përsipër në përputhje me dispozitat e Konventës, veçanërisht me qëllimet dhe objektivat. Në këtë këndvështrim, Konventa parashikon në Nenin 2 një numër parimesh që duhet të drejtojnë Palët për interpretimin dhe zbatimin e Konventës. Këto parime përfshijnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të tilla si liria e shprehjes, informacionit dhe komunikimit. Parimi i hapjes dhe ekuilibrit është themelor përderisa ai përcakton qartë se Shtetet, përmes politikave dhe masave që miratojnë duhet të kërkojnë vazhdimisht të zhvillojnë, në mënyrën e duhur, hapjen ndaj kulturave të tjera të botës. Ky parim i hapjes është në vetvete një garanci për larminë kulturore. Respektimi i parimit të barazisë së të gjitha kulturave është shumë i rëndësishëm në hartimin e politikave dhe masave që duhet të marrin në konsideratë shprehjet kulturore të personave që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë. Respektimi i parimit të së drejtës për përdorim të arësyeshem duke i garantuar çdo individ gëzim efektiv të një game të gjerë të shprehjeve kulturore është gjithashtu shumë i rëndësishëm për të siguruar që larmia kulturore ndahet dhe përjetësohet. Së fundi, duhet të përmendet edhe parimi i komplementaritetit të aspekteve ekonomike dhe kulturore të zhvillimit si edhe ai i zhvillimit të qëndrueshem. Konventa i thekson në mënyrë të veçantë edhe këto parime.

## VEPRIMI I KONVETËS

### 13 KUR FILLON TË VEPROJË KONVENTA?

Konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të 30-të të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit për ato Shtete ose organizata rajonale të integritit ekonomik që i kanë depozituar instrumentet e tyre përkatëse të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit deri në atë ditë. Konventa hyn në fuqi në lidhje me çdo palë tjetër tre muaj pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit (Neni 29).

### 14 KUR FILLON TË VEPROJË KONVENTA?

“Ratifikimi” tregon një akt ndërkombëtar përmes së cilit një Shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik pohon pëlqimin të jetë pjesë e detyrimit në një traktat. Kështu, Konventa dërgohet për të marrë ratifikimin, pranimin, miratimin apo aderimin nga Vendet Anëtare të UNESCO-s instrumentet e të cilave depozitohen tek Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s (Neni 26). Konventa është gjithashtu e hapur për aderim nga të gjitha shtetet joanëtare të UNESCO-s dhe nga çdo organizatë rajonale për integritin ekonomik (Neni 27).

Kështu, një Shtet Anëtar ose një organizatë rajonale për integritin ekonomik që dëshiron të bëhet Palë e Konventës duhet ta ratifikojë atë. Procedura ndërkombëtare që çon në depozitimin e instrumentit të ratifikimit tek Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s është e ndryshme në lidhje me kohëzgjatjen dhe mënyrën e zbatimit, sepse është e veçantë për secilin Shtet Anëtar ose organizatë rajonale për integritin ekonomik.

Një model i instrumentit të ratifikimit (ose pranimit, aderimit apo miratimit, si të jetë e përshtatshme) jepet më poshtë.

#### INSTRUMENTI I RATIFIKIMIT

Duke pasur parasysh që .... (titulli i Konventës)... është e hapur për ratifikim nga ... (emri i vendit)..., sipas kushteve të nenit ....(numri i nenit që zbatohet)...

Prandaj, qeveria e ...(emri i vendit)... pasi mori në konsideratë Konventën e përmendur më sipër, nëpërmjet kasaj ratifikon konventën e dhënë dhe merr përsipër të kryejë kushtet e përmbajtura në të .

Duke qënë dëshmitar në të, unë kam nënshkruar dhe vulosur këtë instrument

Në ....(vendi)...., datë...(data)....  
(Firma)

Kryetari i Shtetit ose Kryeministri ose Ministri i Punëve të Jashtme (vula)

### 15 CILËT JANË MEKANIZMAT PASUES?

Konventa ngre dy organizma përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e Konventës: Konferenca e Palëve dhe Komiteti Ndërqeveritar për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore, i cili ndihmohet nga Sekretariati i UNESCO-s.

Mbledhja e parë e Konferencës së Palëve dhe e Komitetit Ndërqeveritar do të luajë një rol shumë të rëndësishëm për zbatimin efektiv të Konventës.

## 16 ÇFARË ËSHTË KONFERENCA E PALËVE? CILAT JANË FUNKSIONET E SAJ?

Konferenca e Palëve është mbledhja e të gjitha Palëve në Konventë dhe është organi plenar dhe suprem i Konventës (Neni 22). Ajo mbledhet në sesion të zakonshëm çdo dy vjet, dhe, nëse është e nevojshme, në sesion të jashtëzakonshëm. Funkcionet e saj janë si më poshtë: të zgjedhë anëtarët e Komitetit Ndërqeveritar; të miratojë udhëzimet për veprim të përgatitura nga Komiteti për zbatimin e Konventës; dhe të shqyrtojë raportet e Palëve mbi masat që ato kanë marrë në lidhje me Konventën (Nenet 18.4 dhe 22.4.b). Konferenca e Palëve mund të marrë çfarëdo masash të tjera që ajo mund t'i konsiderojë të nevojshme për të ecur përpara për zbatimin e objektivave të Konventës. Për më tepër, Konferenca e Palëve miraton rregullat proceduriale të Komitetit dhe udhëzimet kryesore për përdorimin e burimeve të Fondit Ndërkombëtar për Larminë Kulturore.

## 17 ÇFARË ËSHTË KOMITETI NDËRQEVERITAR? CILAT JANË FUNKSIONET E TIJ?

Komiteti Ndërqeveritar është organi përgjegjës për zhvillimin e objektivave të Konventës dhe inkurajimin e monitorimin e zbatimit të tyre (Neni 23). Anëtarët e Komitetit zgjidhen nga Konferenca e Palëve për një mandat katër vjeçar.

Funksionet kryesore të Komitetit Ndërqeveritar janë: përgatitja e udhëzimeve për veprim për zbatimin e Konventës; transmetimi në Konferencën e Palëve të raporteve nga Palët e Konventës së bashku me komentet dhe një përmbledhje të përmbajtjeve të tyre; dhe marrja e vendimeve për përdorimin e Fondit Ndërkombëtar për Larminë Kulturore. Po ashtu, Komiteti shërben si një organ këshillimor përdorës i kërkohet të japë rekomandime mbi situatat e sjella në vëmendje të tij nga Palët, veçanërisht në rastet kur shprehjet kulturore janë "në rrezik për zhdukje, në kërcënim të rëndë ose ndryshe, në nevojë për mbrojtje urgjente" (Nenet 8 dhe 23.6.d). Komiteti Ndërqeveritar përcakton edhe procedura dhe mekanizma të tjerë për konsultim që synojnë zhvillimin e objektivave dhe parimeve të Konventës në forume të tjera ndërkombëtare.

## 18 CILAT JANË FUNKSIONET E SEKRETARIATIT TË UNESCO-S?

Sekretariati i UNESCO-s ndihmon Konferencën e Palëve dhe Komitetin Ndërqeveritar për organizimin e takimeve të tyre dhe përgatit dokumentacionin përkatës (Neni 24). Sekretariati ndihmon dhe raporton për zbatimin e vendimeve të tyre.

UNESCO, me anë të përdorimit të mekanizmave ekzistues brenda Sekretariatit të tilla si Instituti i Statistikave, lehtëson mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të gjithë informacionit përkatës, statistikave dhe praktikave më të mira mbi larminë e shprehjeve kulturore. UNESCO krijon gjithashtu dhe përditëson një bankë të dhënash për sektorë të ndryshëm dhe organizata qeveritare, private dhe jofitimprurëse të përfshira në fushën e shprehjeve kulturore (Neni 19).

## 19 CILI ËSHTË ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ZBATIMIN E KONVENTËS?

Shoqëria civile nuk është vetëm përfituese e Konventës, por edhe një partnere për zbatimin e saj. Organizatat joqeveritare që përfaqësojnë profesionistët kulturorë, për shembull, kanë marrë pjesë aktive në procesin e hartimit

të Konventës dhe prandaj, është e rëndësishme që shoqëria civile të luajë rolin e saj në zbatimin e Konventës. Në këtë aspekt, Konventa në mënyrë të qartë njih "rolin themelor të shoqërisë civile në mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore" dhe iu bën thirrje Palëve të forcojnë partneritetet me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare dhe sektorin privat për realizimin e objektivave të Konventës (Nenet 11, 12.c, 12.d).

Komiteti Ndërqeveritar mund të ftojë në çdo kohë organizatat apo individët publikë ose privatë të marrin pjesë në mbledhjet e tij për konsultim për çështje të veçanta (Neni 23.7).

## 20 ÇFARË ËSHTË FONDI NDËRKOMBËTAR PËR LARMINË KULTURORE?

Fondi Ndërkombëtar për Larminë Kulturore i krijuar sipas Konventës (Neni 18) është një fond mirëbesimi i vënë në dispozicion të Palëve, veçanërisht të vendeve në zhvillim, për t'i ndihmuar ata për të zbatuar Konventën. Përdorimi i burimeve të Fondit vendoset nga Komiteti Ndërqeveritar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Konferenca e Palëve.

Burimet e Fondit përbëhen kryesisht nga kontribute vullnetare të bëra nga Palët dhe dhurata ose trashëgimi nga shtete të tjera, organizata të tjera rajonale dhe ndërkombëtare, organe apo individë publikë ose privatë. Burimet mund të marrin edhe formën e fondeve të mbledhura me anë të mbledhjeve dhe arkëtimit në aktivitetet e organizuara në dobi të Fondit.

## 21 SI FUNKSIONON MEKANIZMI PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE?

Në Konventë ka një dispozitë për mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ky mekanizëm përdoret për të trajtuar çdo mosmarrëveshje të mundshme ndërmjet Palëve mbi interpretimin ose zbatimin e rregullave apo parimeve specifike të Konventës (Neni 25). Ky mekanizëm i detyron Palët që në fillim të negociojnë përpara se të kërkojnë ndërmjetësim ose ndërhyrje. Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me anë të një ose më shumë prej këtyre mjeteve, ato mund të bëjnë rekurs për pajtim.

Kjo procedurë mund të vihet në lëvizje me kërkesën e një Pale të vetme pjesëmarrëse në mosmarrëveshje. Megjithatë, Palët mund të vendosin të mos e njohin këtë procedure thjesht duke bërë një deklaratë për këtë qëllim në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. Në këtë kuptim, Konventa vendos mekanizmat e saj në dispozicion të Palëve duke dëshiruar që ato të përdoren për të lehtësuar zgjidhjen efektive të konflikteve me Palët e tjera që e kanë pranuar atë.

Së fundi, mekanizmi i zgjidhjes së konfliktit është detyruar vetëm për Palët në Konventë, të cilat janë patjetër Shtete ose organizata rajonale të integritit ekonomik. Kështu, megjithëse Konventa në shumë aspekte njih rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile dhe të sektorit privat për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, mekanizmi për zgjidhjen e konfliktit nuk vihet në dispozicion të aktorëve që nuk janë Palë në Konventë (të tilla si ndërmarrjet), mbi të cilët Konventa nuk ka fuqi ligjore.

## 22 A I PËRCAKTON KONVENTA MARRËDHËNIET E SAJ ME INSTRUMENTË TË TJERA NDËRKOMBËTARE LIGJORE?

Konventa është një instrument ndërkombëtar ligjor që merret me larminë e shprehjeve kulturore. Megjithëse fusha e saj e zbatimit kufizohet tek "politikat dhe masat e miratuara nga Palët në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore" (Neni 3, shikoni Pyetjen 8), zbatimi i dispozitave të Konventës mund të zbulojë pika



të caktuara ndërveprimi ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të Palëve të përfshira në këtë traktat dhe të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga instrumente të tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë Palë.

Në këtë drejtim, Neni 20 i Konventës përcakton marrëdhënien me traktate të tjera ndërkombëtare dhe specifikon marrëdhënien midis këtyre traktateve në rast të mbivendosjes së të drejtave dhe detyrimeve. Sipas këtij neni, Palët duhet të përmbushin me mirëbesim detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente dhe të të gjitha traktateve të tjera që ato kanë nënshkruar, pa e vënë këtë Konventë në varësi të traktateve të tjera. Për arritjen e këtij qëllimi, Konventa u bën thirrje Palëve të nxisin mbështetjen e ndërsjellë ndërmjet Konventës dhe traktateve të tjera. Ajo, gjithashtu u bën thirrje Palëve të marrin parasysh dispozitat përkatëse të Konventës kur interpretojnë apo zbatojnë traktate të tjera ku ato janë Palë, ose kur hyjnë në detyrime të tjera ndërkombëtare.

## 23 SI I TRAJTON KONVENTA MARRËDHËNIET ME INSTRUMENTE TË TJERA NDËRKOMBËTARE?

Neni 20 i Konventës shprehet qartë se asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si ndryshuese e të drejtave dhe detyrimeve të Palëve sipas ndonjë traktati tjetër ku ato janë Palë.

Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha traktatet, pavarësisht nëse ato aktualisht janë në fuqi ose janë duke u përgatitur. Kështu, Neni 20 në mënyrë shumë besnike pasqyron një prej objektivave kryesore të Konventës, atë të njohjes së natyrës së dyfishtë ekonomike dhe kulturore të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore. Të gjitha fushat e legjislacionit ndërkombëtar që kanë të ngjarë të ndërveprojnë me zbatimin e kësaj Konvente janë parashikuar në frymën e komplementaritetit dhe mbështetjes së ndërsjellë. Megjithëse të gjitha traktatet ndërkombëtare kanë objektiva të ndryshëm, plotësimi i këtyre objektivave mund të bëhet në mënyrë komplementare.

Së fundi, në interes të veprimit të përbashkët dhe bashkërendimit ndërmjet instrumenteve ndërkombëtare ligjore, Palët marrin gjithashtu përsipër të zhvillojnë objektivat dhe parimet e kësaj Konvente në forume të tjera ndërkombëtare dhe të konsultohen me njëra-tjetrën për këtë qëllim (Neni 21). Kjo është një mënyrë tjetër e njohjes së bashkëpunimeve që ka mundësi të lindin ndërmjet Konventës dhe traktateve të tjera ndërkombëtare, dhe Palët janë përgjegjëse për krijimin e "urave" të tilla ndërmjet forumeve të ndryshme ndërkombëtare të negociatave.

## PYETJE TË TJERA

### 24 CILAT JANË PËRPARËSITË E RATIFIKIMIT TË KËSAJ KONVENTE?

Merita e Konventës qëndron në vendin që ajo i jep krijimtarisë në kontekstin e globalizimit. Efekti i përgjithshëm i dispozitave të saj është të përfitojnë individët dhe shoqëritë në tërësi duke iu garantuar atyre gëzimin e larmisë së shprehjeve kulturore në frymën e hapjes, ekuilibrit dhe lirisë.

Përfituesit kryesorë janë vendet që kanë mungesë kapacitetesh për të prodhuar dhe përhapur shprehjet e tyre kulturore, veçanërisht vendet në zhvillim. Konventa ka efekte pozitive edhe për artistët dhe profesionistët kulturorë, d.m.th. për të gjithë ata të përfshirë në procesin e krijimit, prodhimit dhe shpërndarjes së shprehjeve kulturore, individualisht apo kolektivisht. Përfitues të tjerë janë institucionet dhe ndërmarrjet kulturore, publike dhe private, duke përfshirë ata që i përkasin edhe sektorit informal, si edhe organizatat jofitimprurëse që marrin pjesë në të njëjtin proces.

## 25 CILAT JANË PËRFITIMET PËR VENDET NË ZHVILLIM?

Megjithëse vendet në zhvillim janë të pasura me krijimtari dhe shprehje kulturore, ka një dallim të madh ndërmjet kapaciteteve të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim në lidhje me prodhimin dhe përhapjen e shprehjeve të tyre kulturore, duke pakësuar kështu mundësitë e vendeve në zhvillim për të dhënë kontributin e tyre aktiv për larminë kulturore në nivel ndërkombëtar. Prandaj, një numër dispozitash të Konventës iu drejtohen vendeve në zhvillim. Këto dispozita bëjnë thirrje për të marrë masa për: forcimin e industrive të tyre kulturore dhe të kapaciteteve të tyre institucionale dhe drejtuese; transferimin e teknologjive dhe njohurive dhe përdorimin e formave të ndryshme të ndihmës financiare (Neni 14). Mbështetja për disa prej këtyre projekteve të bashkëpunimit do të ofrohet nga Fondi Ndërkombëtar (Neni 18).

## 26 A MERRT KONVENTA ME PERSONAT QË U PËRKASIN MINORITETEVE DHE POPUJVE INDIGJENË?

Megjithëse Konventa nuk i kushtohet në mënyrë të veçantë shprehjeve kulturore të minoriteteve dhe popujve indigjenë, teksti i Konventës njih rëndësinë e këtyre shprehjeve për larminë e shprehjeve kulturore. Po ashtu, Preambula e Konventës na kujton për rëndësinë e formave tradicionale të njohurive – në veçanti për sistemet e njohurive të popujve indigjenë – si një burim i pasurisë materiale dhe jomateriale dhe për kontributin e tyre pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm. Më tej, Konventa pohon parimin e dinjitetit të barabartë dhe të respektit për të gjitha kulturat, përfshirë kulturat e personave që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë (Neni 2.3). Po ashtu, ajo u bën thirrje Palëve t'i kushtojnë vëmendjen e duhur rrethanave dhe nevojave të veçanta të grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë" (Neni 7.1.a) për ushtrimin e të drejtave të tyre në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Personat që u përkasin minoriteteve dhe popujve indigjenë janë depozita njohurish që zënë një vend të veçantë në larminë e shprehjeve kulturore për gamën e gjerë dhe origjinalitetin e pikëpamjeve botërore që ata transmetojnë. Megjithatë, shprehjet e tyre kulturore shpesh dobësohen. Për këtë arsye, ka të ngjarë që ato të bëhen prioritet në kuadër të kësaj Konvente.

## 27 A E TRAJTON KONVENTA PRONËSINË INTELLEKTUALE?

Konventa nuk merret në mënyrë të veçantë me pronësinë intelektuale, e cila në nivel ndërkombëtar trajtohet kryesisht brenda kompetencave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), me të cilën UNESCO është konsultuar në mënyrë informale në kuadër të përgatitjes së këtij instrumenti. Megjithatë, Konventa nuk e lë mënjanë rëndësinë e pronësisë intelektuale për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore. Në Preambulën e saj, Konventa njih rëndësinë e këtyre të drejtave për individët që marrin pjesë në krijimtarinë kulturore (paragrafi 17) dhe nevojën për të siguruar mbrojtjen dhe zhvillimin e njohurive tradicionale – në veçanti për sistemet e njohurive të popujve indigjenë – si një burim i pasurisë jomateriale dhe materiale (paragrafi 8).

## 28 A E TRAJTON KONVENTA LARMINË GJUHËSORE?

Gjuhët janë një pjesë thelbësore e larmisë së shprehjeve kulturore. Roli themelor i larmisë gjuhësore për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë kulturore vihet në dukje në Preambulën e Konventës. Për më tepër, Neni 6.2.b për masat që duhet të merren nga Palët në Konventë për të siguruar, në mënyrën e duhur, mundësi për veprimtari, të mira dhe shërbime kulturore në vend midis të gjitha atyre që janë në dispozicion brenda territorit kombëtar, i referohet gjithashtu edhe masave që merren në lidhje me gjuhën e përdorur në veprimtari, të mira dhe shërbime të tilla. Kjo do të thotë që Palët, në kontekstin e politikave dhe masave që lejohen të zbatohen për të nxitur larminë e shprehjeve kulturore, gjithashtu duke respektuar liritë themelore të njeiut dhe parimet e balancës dhe të hapjes që

burojnë nga Konventa, mund të nxisin larminë gjuhësore në fazat e ndryshme të krijimit, prodhimit, shpërndarjes dhe përhapjes së shprehjeve kulturore me anë të veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve (shikoni Pyetjen 9).

## 29 A E KUFIZON KONVENTA RRJEDHJEN E LIRË TË IDEVE DHE INFORMACIONIT? A MUND TË PËRDORET AJO PËR TË JUSTIFIKUAR CENZURËN?

Preambula e Konventës pohon përsëri se “liria e mendimit, shprehjes dhe informacionit si edhe larmia e medias bëjnë të mundur që shprehjet kulturore të zhvillohen e lulëzojnë brenda shoqërive” (paragrafi 12). Përveç kësaj, parimi i parë drejtues i referohet respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Neni 2.1). Për pasojë, Konventa mund të shmanget nga qëllimet e saj për aq kohë sa Shtetet shkelin të drejtat e njeriut të njohura në instrumentet ligjore ndërkombëtare.

Megjithëse Konventa pohon përsëri të drejtën sovraane të Shteteve për të miratuar politika dhe masa që nxisin larminë e shprehjeve kulturore, ajo shpreh qartë se Shtetet duhet të respektojnë dispozitat e saj dhe si pasojë, objektivat, parimet, të drejtat dhe detyrimet që ajo parashikon. Konventa është larg favorizimit të censurës, ajo ofron mbrojtje shtesë përveç dispozitave ekzistuese për mbrojtjen e të drejtave themelore.

Rreziku i censurës nga qeveria ka shumë pak të ngjarë të ndodhë, përderisa parimi i sovranitetit të Palëve në Konventë shoqërohet me “parimin e hapjes dhe ekuilibrit” (Neni 2.8) me kushtin që Shtetet, duke miratuar këto politika dhe masa “duhet të kërkojnë të nxisin, në mënyrën e duhur, hapjen ndaj kulturave të tjera të botës...”. Kjo hapje, për më tepër, merr formën e të drejtave dhe detyrimeve përderisa sipas Neni 7 “Palët do të përpiqen të krijojnë në territorin e tyre një mjedis që inkurajon individët dhe grupet shoqërore (...) të përdorin shprehje të ndryshme kulturore nga territori i tyre si edhe nga vende të tjera të botës”. Së fundi, Palët duhet të kërkojnë ndarjen e informacionit dhe transparencën duke ofruar çdo katër vjet në raportet e tyre për UNESCO-n informacion të duhur mbi masat e marra për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore (Neni 9).

## 30 A MUNDËT QË KONVENTA TË KETË NDIKIM NË REGJIMIN TREGTAR TË SHTETEVE PALË?

Konventa merret me larminë e shprehjeve kulturore dhe synon të mbrojë dhe zhvillojë këtë larmi, në veçanti me anë të politikave dhe masave kulturore dhe përmes forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Megjithatë, disa mendojnë se këto politika dhe masa – që synojnë për shembull në inkurajimin artistëve të vendit dhe të prodhimeve në vend – mund të kenë ndikim në regjimin tregtar të Shteteve Palë.

Sapo Konventa hyn në fuqi për Shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik, ajo as nuk do të ndryshojë, e as do të modifikojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumente të tjera ligjore ku ata janë Palë, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare për tregtinë, në nivel dypalësh, rajonal ose shumëpalësh.

Duke plotësuar serinë e instrumenteve ligjore të UNESCO-s për vendosjen e standardeve në fushën e kulturës, Konventa nuk e vë në diskutim pavarësinë apo autonominë e të drejtës ndërkombëtare të tregtisë. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të theksohet se termi “mbrojtje” i përdorur në kontekstin e kësaj Konvente ka të bëjë me “miratimin e masave që synojnë ruajtjen, sigurimin dhe shtimin e larmisë së shprehjeve kulturore” (Neni 4.7). Ky është kuptimi në të cilin termi përdoret në instrumente të ndryshme të UNESCO-s në fushën kulturore, si tek Konventa e vitit 1972 mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, Konventa e vitit 2001 mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore dhe Konventa e vitit 2003 për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Në këtë Konventë, termi “mbrojtje” i shoqëruar me termin “zhvillim” pasqyron nevojën për të ruajtur vitalitetin – nëse jo mbijetesën – e shprehjeve kulturore të vëna në rrezik nga proceset përshpejtuese të globalizimit.